

# Raiffeisen Invest Albania

## Raport Vjetor 2018

Raiffeisen Invest sh.a.  
Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion  
Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj  
Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro  
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Ky raport nuk është një ofertë ose reklamë për shitjen e kuotave të fondeve të Raiffeisen INVEST.

Raporti vjetor përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve për vitin 2018, të audituara nga shoqëria KPMG Albania sh.p.k.

---

Përmbytje

<b>Mesazh nga Këshilli i Administrimit</b>	4
<b>Mesazh nga Administratori i Përgjithshëm</b>	5
<b>Raiffeisen Invest sh.a.</b>	7
Misioni dhe Vlerat	7
Qeverisja e Korporatës	8
Kodi i Etikës	9
Konflikti i Interesit	9
Transparenca	10
Proçesi i Investimit	10
Burimet Njerëzore	11
<b>Përgjegjësia Sociale</b>	12
<b>Edukimi financiar</b>	15
<b>Raport i Menaxherëve të Fondeve</b>	16
Performanca e Fondeve – 31 Dhjetor 2018	16
Tarifat e Fondeve	16
Zhvillimet Ekonomike	17
<b>Fondi Raiffeisen Vizion</b>	19
Politika e Investimit	19
Performanca e Fondit	19
Strategjia e investimit gjatë vitit 2019	20
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	20
<b>Fondi Raiffeisen Prestigj</b>	21
Politika e Investimit	21
Performanca e Fondit	22
Strategjia e investimit gjatë vitit 2019	22
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	23
<b>Fondi Raiffeisen Invest Euro</b>	24
Politika e Investimit	24
Performanca e Fondit	25
Strategjia e investimit gjatë vitit 2019	25
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	26
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	27
Politika e Investimit	27
Performanca e Fondit	27
Strategjia e zhvillimit të fondit gjatë vitit 2019	28
Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve	28
<b>Raport i Menaxherit të Rrezikut</b>	29
<b>Pasqyrat Financiare &amp; Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	30
<b>Raiffeisen Invest sh.a – Shoqëria administruese</b>	38
<b>Fondi Raiffeisen Prestigj</b>	62
<b>Fondi Raiffeisen Invest Euro</b>	66
<b>Fondi Raiffeisen Vizion</b>	70
<b>Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen</b>	74

# Mesazh nga Këshilli i Administrimit

Të nderuar investitorë!

Viti 2018 ishte një tjetër vit i suksesshem për shoqërinë administruese të fondeve Raiffeisen Invest sh.a. e cila vijoi të mbetet shoqëria lider në tregun shqiptar të manaxhimit të fondeve dhe vazhdoi rritjen saj nepermjet produkteve financiare të ofruara për investitorët duke hedhur në treg me sukses fondin e ri të investimeve Raiffeisen Vizion, në linjë me strategjinë e saj.

Fondi Vizion, sikurse dhe fondet e tjera në administrim, u prit me shumë interes nga investitorët vendas duke ju dhënë mundësi me teper në diversifikim të portfolit të investimit. Ky fond i dha frytë e para që në gjashmujorin e parë të tregimit në publik, duke qenë një alternative e mirë investimi në tregun lokal i cili u karakterizua nga norma të ulta të interesit.

Fokusi i kompanisë për të ardhmen do të vazhdojë në ofrimin e fondeve dhe planeve të reja të investimit për të nxitur zhvillimin e tregut të kapitaleve. Për të arritur këtë kompania ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin rregullator i cili ka hartuar një ligj të standarteve Europiane. Ky ligj do të ndihmojë të gjithë lojtarët e tregut të ofrojnë një game të gjere të produkteve për të qenë me afër kërkesave në rritje të investitoreve.

Treguesit ekonomike në Shqipëri kanë pasur përmirësim të moderuar me një rritje ekonomike të qëndrueshme duke krijuar një mjedis akomodues për zhvillimin e tregut lokal financiar.

Në tregun lokal normat e interesit kanë ndjekur një trend zbritës duke ndihmuar në kthyesmerinë e fondeve në Leke.

Kompania ka forcuar pozitën e vet në tregun shqiptar duke manaxhuar me sukses një total asetesh prej 64.7 miliard leke. Po kështu Fondi në EURO ka vazhduar të shihet me interes nga investitorët vendas si një ndër alternativat më të mira të investimeve në monedhën Euro, krahasuar me ato që ofron tregu financiar shqiptar.

Të gjitha shërbimet financiare të ofruara nga shoqëria në tregun vendas janë në përputhje të plote me të gjitha standartet dhe direktivat Europiane për tregjet e kapitaleve për të qenë sa më transparente me investitorin. Kjo ka qenë gjithmone një nga detyrat kryesore të kompanisë dhe falë punës së palodhur të një ekipi ekspertësh është arritur realizimi me sukses i saj. Cdo arritje e shoqërisë është rrjedhojë e punës së tyre profesionale.

Gjatë vitit në vazhdim shoqëria Raiffeisen Invest sh.a do të vazhdojë të ndjekë strategjinë e ofrimit të produkteve të reja financiare për tregun shqiptar duke plotësuar kërkesat në rritje të investitoreve vendas. Të qenit inovatore për tregun lokal e ka ndihmuar shoqërinë të forcojë pozitën e vet në tregun vendas.

Në emër të Këshillit të Administrimit dua të falënderoj sigurisht të gjithë investitorët tanë për besimin e treguar ndër vite për produktet e ofruara nga ne si dhe bashkëpunimin e frytshëm që kemi pasur duke i siguruar se stafi i Raiffeisen Invest do të jetë gjithmonë në shërbim të tyre.



**Donalda Gjorga**

**Kryetare e Këshillit të Administrimit**

# Mesazh nga Administratori i Përgjithshëm

Të nderuar investitorë!

Viti 2018 ishte njëkohësisht vit sfidash e suksesesh. Objektivi i Raiffeisen Invest u orientua në manaxhimin e produktit me fokus final investitorin shqiptar, më tepër se sa në rritjen e asetëve. Ne lançuam me sukses në Gusht të vitit 2018 një fond të ri në lekë – Raiffeisen Vizion – i cili është i përshtatshëm për investitorët me një horizont investimi afatgjatë dhe të gatshëm të marrin përsipër një nivel më të lartë rreziku në raport me fondin Raiffeisen Prestigj. Fondi rezultoi i suksesshëm pasi arriti nivelin e 50 milion eurove në fund të vitit dhe regjistroi më shumë se 2.000 investitorë.

Në këtë mënyrë, Raiffeisen Invest forcoi pozitat e liderit, duke rritur në 3 numrin e fondeve të saj investimit si dhe në 5 numrin e fondeve të investimit në treg.

Nga ana tjetër, 2018-a ishte vit sfidash për shumicën e menaxherëve të fondeve në botë, pasi tregjet financiare dhanë sinjale paqëndrueshmërie dhe nervozizmi dhe regjistruan tkurrjen më të madhe që nga kriza financiare e vitit 2008. Kryesisht në tremujorin e fundit të vitit tregjet e obligacioneve dhe aksioneve ranë paralelisht, çka është e rrallë.



Efektivi i ecurisë së tregjeve ndërkombëtare u reflektua edhe në fondin tonë në euro -Raiffeisen Invest Euro, i cili pësoi tkurrje në raport me vitin 2017. Ndërkohë, në tregun lokal, në pjesën e parë të vitit, yield-et e titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare treguan rritje të lehtë për të gjitha maturitetet, çka ndikoi në rënien të performancës së fondit në lekë-Raiffeisen Prestigj. Kjo e fundit rikuperoi në gjysmën e dytë të vitit, pas uljes së normës bazë repo në nivelin më të ulët historik prej 1% nga Banka Qëndrore, dhe rënies së yield-eve, sidomos për titujt afatgjatë.

Pavarësisht luhatshmërive që janë pjesë e natyrshme e fondeve të investimit, ekipi i Raiffeisen Invest menaxhoi me përkushtim dhe profesionalizëm asetet e investitorëve. Në tre fondet në monedhë vendase (Prestigj, Vizion dhe Pension) ku mungon mundësia për diversifikim mbi bazë emetuesi, investimi i asetëve pati në fokus balancën e drejtë midis kthimit dhe likuiditetit. Fondi në monedhën Euro, pavarësisht natyrës si fond obligacionesh ofroi mundësi diversifikimi sipas emetuesve (obligacione të qeverive, korporatave apo fonde të tjera investimi) dhe sektorëve (financiar, telekomunikacion, shëndetësi, transport etj.). Në të katër fondet, vëmendje e veçantë është treguar për mbajtjen e niveleve të duhura të likuiditetit për të mundësuar shlyerjen në kohë të investitorëve.

Në një mjedis normash të ulëta interesi, fondet e investimit mbeten një mundësi komode për të investuar kursimet në Lekë dhe në Euro, dhe njëkohësisht për të diversifikuar portofolin jashtë spektrit të produkteve bankare.

Viti 2018 u mbyll me afërsisht 519 milion euro asete në fondet e investimit nën administrim të Raiffeisen Invest, çka përkthehet në një rënie prej 4.5% krahasuar me fundin e vitit 2017. Nga ana tjetër, fondi vullnetar i pensionit u rrit me 23% duke kapur vlerën e 5 milion eurove. Në total, asetet që na besuan më shumë se 31,000 investitorë arritën në 523 milion euro.

## Pritshmëritë për vitin 2019

Viti 2019 do të jetë një tjetër vit sfidash, kryesisht për fondet në lekë, pasi yield-et e bonove dhe obligacioneve të Thesarit kanë arritur nivele mjaft të ulëta e pritet të kenë luhatshmëri, në funksion të rritjes ekonomike dhe zhvillimeve politike, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ne jemi të angazhuar që të përshtasim në mënyrë proaktive politikat e investimit dhe manaxhimit të rrezikut me sinjalet e dhëna nga tregjet, me qëllim që investitorët, në terma afatmesëm, të marrin sigurinë dhe përfitueshmërinë e pritur. Transparenca ndaj tyre, si në procesin e shitjes së fondeve, ashtu edhe në atë të mirëmbajtjes së marrëdhënies ekzistuese investitor-shoqëri administruese, mbetet detyrim dhe angazhim i padiskutueshëm.

Gjithashtu, me qëllim për t'i shërbyer sa më mirë investitorit shqiptar, Raiffeisen Invest do të fokusohet në dizejnimin dhe lançimin e fondeve të reja të investimit, kryesisht në monedhë të huaj, me profil rreziku të ndryshëm nga fondet ekzistuese. Ky objektivi përkon me iniciativën e ndërmarrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të përmirësuar legjislacionin që rregullon aktivitetin e fondeve të investimit, çka do t'i hapë rrugë krijimit të alternativave të reja të investimit për publikun shqiptar.

Një objektivi tjetër shumë i rëndësishëm do të jetë të qenurit lider të inovacionit në fushën e fondeve të investimit e pensionit, fillimisht duke u ofruar klientëve akses në llogaritë e tyre të investimit nëpërmjet platformes dixhitale Raiffeisen ON/aplikacionit në telefonin celular, e më pas duke e zgjeruar dixhitalizimin tek transaksionet e kryera për llogari të fondeve. Të gjitha këto përmirësojnë cilësinë e shërbimit për investitorin dhe lehtësojnë procesin e investimit.

Në përfundim, Ju falënderoj edhe njëherë për besimin tuaj dhe ju garantoj që edhe gjatë këtij viti që vjen ne do të vijojmë të menaxhojmë fondet tuaja me përkushtim, integritet dhe transparencë.



**Edlira Konini**  
Administratore e Përgjithshme

# Raiffeisen Invest Sh.a

Raiffeisen Invest sh.a është shoqëria e l-rë e liçençuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar & sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Raiffeisen Invest sh.a ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Direktivat e Grupit Raiffeisen dhe praktikat më të mira në fushën e menaxhimit të aseteve.

Raiffeisen Invest sh.a është subjekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Administrimi i fondeve kryhet tërësisht nga stafi i Raiffeisen Invest sh.a;

Raiffeisen Invest sh.a, gjatë vitit 2018, hodhi ne treg Fondin më të ri të investimeve, Raiffeisen Vizion. Kështu, nën menaxhimin e saj numërohen tre (3) fonde investimi, përkatësisht Fondi Raiffeisen Prestigj në lekë, Fond Raiffeisen Invest Euro në monedhën euro, Fondi Raiffeisen Vizion në lekë, si dhe Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen;

Edhe gjatë vitit 2018, Raiffeisen Invest sh.a vazhdoi të ruante pozicionin e shoqërisë lider në tregun financiar shqiptar në fushën e administrimit të aseteve, me një fokus të qartë në kujdesin ndaj investitorëve, transparencën ndaj tyre, dhe zbatimin e praktikave më të mira.

Numri i klienteve deri në fund të vitit 2018 ishte 31 559 klientë, me një total asetesh nën administrim prej 64,674,985,315 lekë.

## Misioni dhe Vlerat

### Misioni:

T’u ofrojmë investitorëve alternativa të reja dhe të përshtatshme investimi, bazuar në parime dhe profesionalizëm, duke mundësuar zhvillimin e tregut të kapitalit në vend, nëpërmjet fokusimit dhe jo vetëm në:

- Njohjen e klientëve tanë dhe orientimin e tyre drejt vendimarrjes së duhur të investimit;
- Menaxhimin cilësor të aseteve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Mirëqeverisjen e korporatës;
- Krijimin e opsioneve të reja për investim, paralelisht me rritjen e edukimit financiar të publikut mbi fondet e investimit & pensionit vullnetar.

### Vlerat:

- Jemi pjesë e Grupit Raiffeisen, një emër i madh bazuar në standarte;
- Jemi shoqëria lider në menaxhimin e aseteve në tregun shqiptar ;
- Aplikojmë profesionalizëm maksimal dhe praktikat më të mira të menaxhimit të aseteve;
- Investojmë bazuar në integritet, transparencë dhe standarte të larta;

# Qeverisja e Korporatës

Raiffeisen INVEST sh.a është shoqëri aksionare, e organizuar sipas sistemit me një nivel drejtimi, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Selia e shoqërisë është në Blv. "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-te, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a.

Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët Ekzekutivë.

## 1. Asambleja e aksionarëve:

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë Raiffeisen Bank sh.a.

## 2. Këshilli i Administrimit:

Këshilli i Administrimit është organi qëndror i Shoqërisë Raiffeisen Invest sh. a i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit.

### 2.1 Përbërja:

<b>Kryetare</b>	<b>Donalda Gjorga</b> Chief Dealer - Departamenti i Thesarit - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Nën kryetar</b>	<b>Peter Zilinek</b> Drejtor për Steering në Departamentit EQL - Raiffeisen Capital Management, Austri.
<b>Anëtare</b>	<b>Vilma Baçe</b> Drejtoreshë për Shitjet dhe Shpërndarjen - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtare</b>	<b>Alda Shehu</b> Drejtoreshë e Divizionit të Financës - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtar</b>	<b>Joan Canaj</b> Drejtor i Divizionit të Riskut të Integruar - Raiffeisen Bank Albania, Tiranë
<b>Anëtare</b>	<b>Edlira Konini</b> Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest, sh.a
<b>Anëtare</b>	<b>Alketa Emini (Gjoçaj)</b> Zv/Administratore e Përgjithshme - Raiffeisen Invest, sh. a

## 3. Komiteti i Investimeve

Vendimarrja në procesin e rëndësishëm të investimit si dhe mbikëqyrja e këtij procesi i është besuar Komitetit të Investimeve. Komiteti i Investimeve është një organ kolegjal, vendimarrës dhe mbikëqyrës. Ai monitoron nëse procesi i investimit është në përputhje me Politikën e investimit të secilit fond të miratuar nga Këshilli i Administrimit si dhe në përputhje me Politikën e manaxhimit të riskut dhe kërkesat rregullatore.

### 3.1 Përbërja:

1. Nënkyetari i Bordit Drejtues (RBAL)	Kryetar
2. Anëtari i Bordit për Retail (RBAL)	Anëtar
3. Drejtori i Departamentit të Riskut të integruar (RBAL)	Anëtar
4. Drejtori Divizionit të Manaxhimit të E-banking (RBAL)	Anëtar
5. Administratori i Përgjithshëm (RIAL)	Anëtar
6. Zv/ Administratori i Përgjithshëm (RIAL)	Anëtar
7. Drejtori i Manaxhimit të Fondeve (RIAL)	Anëtar
8. Drejtori i Manaxhimit të Riskut	Anëtar



Oficeri i Përputhshmërisë merr pjesë dhe monitoron çdo mbledhje të Komitetit të Investimeve. Komiteti i Investimeve zhvillon mbledhje të rregullta, të paktën 1 herë në muaj.

## 4. Ekipi Drejtues i Raiffeisen Invest

### **Edlira Konini**

Administratore e Përgjithshme

### **Alketa Emini (Gjoçaj)**

Zv/Administratore e Përgjithshme

### **Lizander Saraçi**

Drejtor i Departamentit të Riskut

### **Rezarta Arapi**

Drejtoreshë e Menaxhimit të Fondeve

### **Brunilda Haxhimihali (Emini)**

Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & PPP

## Kodi i Etikës

Në ushtrimin e aktivitetit të administrimit të aseteve Raiffeisen Invest sh.a, bazohet në legjislacionin shqiptar si dhe udhëhiqet nga Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen.

Kodi i Etikës së Grupit Raiffeisen përshkruan vlerat e përbashkëta dhe standartet bazë të sjelljes etike në biznes, që duhet të ndiqen nga të gjithë shoqëritë e Grupit. Ai udhëheq veprimtarinë e përditshme me të gjitha palët, brenda dhe jashtë shoqërisë.

Kryerja e veprimtarisë tregtare në mënyrë etike, të ligjshme dhe me përgjegjshmëri të lartë është thelbi i kulturës së shoqërisë Raiffeisen Invest sh.a.

Kodi i Etikës Raiffeisen është i detyrueshëm për çdo punonjës, dhe ka si qëllim të sigurojë që sjellja në marrëveshjet e biznesit dhe çëshjet e etikës të jenë në përputhje me standartet tona të larta. Standartet bazohen në vlerat në vijim :

- **Orientimi ndaj Klientit**
- **Profesionalizmi**
- **Cilësia**
- **Respekti reciprok**
- **Iniciativa**
- **Puna në grup**
- **Integriteti**
- **Qeverisja e mirë e korporatë**

## Konflikti i Interesi

Çdo punonjës i Raiffeisen Invest është i përkushtuar për të identifikuar dhe shmangur konfliktin potencial të interesit gjatë ushtrimit të detyrave.

Anëtarët e Komitetit të Investimeve si dhe të Këshillit të Administrimit duhet të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm interesi.

Të gjithë punonjësit duhet të sigurojnë që interesat e tyre nuk bien në konflikt me detyrimet e tyre ndaj shoqërisë apo me detyrimet e shoqërisë ndaj investitorëve.

Në veçanti punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të asetëve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal, i cili mund të jetë në konflikt me manaxhimin e investimeve në mënyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

Raiffeisen Invest sh.a ka në strukturën e saj organizative, Njësinë e Përputhshmërisë, një nga detyrat e veçanta të së cilës është parandalimi, identifikimi dhe manaxhimi i konflikteve të interesit midis shoqërisë dhe fondeve të saj, si dhe ndërmjet fondeve në mënyrë që të sigurohet që investitorët të mos jenë në disavantazh përmes konflikteve të interesit.

## Transparenca

Një nga parimet me të rëndësishme ku bazohet veprimtaria e Raiffeisen Invest sh.a, është Transparenca ndaj Investitorit. Faqja zyrtare e shoqërisë, e cila përditësohet dhe mirëmbahet vazhdimisht luan një rol të rëndësishëm në informimin e investitorëve dhe publikut. Në web-site të shoqërisë publikohen periodikisht të gjitha raportet e ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë, si dhe të gjitha fondeve nën administrim, informacione të përditësuara rreth fondeve dhe dokumentacionit të tyre, mënyrës së investimit në fond, publikimi i çmimit të kuotës çdo ditë etj. Çdo investitor mund të aksesojë në çdo kohë llogarinë personale në fond, duke u njohur me ecurinë e investimit të tij dhe të ketë mundësi të marrë vendime në kohën e duhur.

Ndërkohë, stafi i Raiffeisen Invest sh.a., është në komunikim të vazhdueshëm me investitorët si nëpërmjet e-mail apo telefonatave duke sqaruar çdo pyetje apo kërkesë që lidhet me investimin e tyre.

## Procesi i Investimit

Manaxhimi i portofolit bëhet duke implementuar "Rregullin e personit të kujdesshëm". Ky rregull detyron menaxherët e fondeve që të veprojnë dhe të investojnë me të njëjtin gjykim, kujdes e mençuri, me të cilin do të vepronte një person i kujdesshëm që po menaxhon asetet e tij, jo për motive spekulimi, por për një motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondet e administruara nga Raiffeisen Invest sh.a., manaxhohen nga profesionistët më të mirë në treg, me profesionalizëm dhe "kujdesin e duhur", të denjë për besimin e publikut dhe me motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe të ardhurave potenciale që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

---

# Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në implementimin e strategjisë së Raiffeisen Invest, si dhe në arritjen e objektivave të shoqërisë ; Eksperienca dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore është në fokusin kryesor të shoqërisë.

Raiffeisen Invest sh.a., ndonëse një shoqëri me staf të vogël në numër, por të talentuar dhe të përkushtuar, përpiqet t'u sigurojë investitorëve tanë manaxhim profesional dhe të kujdesshëm të aseteve të tyre.

Raiffeisen Invest sh.a. ka tërhequr disa nga ekspertët më të mirë në tregun shqiptar të kapitalit, me background shumë të mirë edukimi, si dhe përvojë në sektorin financiar.

Shoqëria në fund të vitit 2018 kishte 15 punonjës me kohë të plotë.

Edhe gjatë vitit 2018, shoqëria tregoi angazhimin maksimal në zhvillimin e stafit të saj, përmes trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm.

Një sistem i ri, i cili mundëson zhvillimin e moduleve të trajnimit online, është prezantuar në shumicën e institucioneve të grupit Raiffeisen, përfshirë edhe Shqipërinë.

Përmes këtij sistemi, stafi i RIAL ka marrë një sërë trajnimesh një pjesë e të cilave janë shoqëruar edhe me testimin e njohurive të marra, përpara çertifikimit.

Në kuadrin e trajnimeve të marra nga stafi i RIAL përmëdim : "Manaxhimi i riskut operacional", "Përputhshmëria rregullative dhe Parandalimi i pastrimit të parave", "Përputhshmëria në tregun e kapitaleve" etj.

# Përgjegjësia Sociale

Raiffeisen Invest sh.a, si pjesë e një grupi të madh dhe shoqëri lider në treg, tashmë e ka përfshirë përgjegjësinë sociale si pjesë të misionit të saj, duke vazhduar me përkushtim dhe dedikim të kontribuojë me të gjitha shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjatë vitit 2018, një sërë projektesh me fokus kryesisht edukimin dhe mbrojtjen e mjedisit, por edhe projektet lidhur me mbrojtjen sociale, shëndetin dhe promovimin e artit dhe kulturës në vend, kanë tërhequr vëmendjen dhe mbështetjen e Raiffeisen Invest sh.a.

Të rëndësishme kanë qënë kontributet e saj në sektorin shëndetësor, arsimor, mjedisor si dhe në kulturë & art.

Në sektorin e shëndetësisë, vlen të përmenden një sërë projektesh që lidhen me rikonstrukcionin e disa spitaleve në qytete të ndryshme, përmirësimin e kushteve të tyre, si dhe blerjen e pajisjeve/aparaturave shëndetësore bashkëkohore. Këtu mund të përmendim Projektet për "Rikonstrukcionin e spitalit të Lezhës", "Rikonstrukcionin e spitalit të Sarandës", "Rikonstrukcionin e spitalit të Dibrës", Blerja e pajisjeve për laboratorin bakteorologjik Fier", "Blerja e ECHO-s për Spitalin e Bilishtit" etj.

Në fushën e arsimit, vlen të përmenden projektet e mbështetura nga Raiffeisen Invest sh.a dhe të zhvilluara nga Drejtoritë Rajonale Arsimore Fier, Krujë, Kavajë, Himarë si dhe Bashkitë e Krujës, Konispolit etj. Këto projekte lidhen me blerjen e pajisjeve të nevojshme për institucionet e arsimit, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e tyre, si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore në funksion të procesit të edukimit. Më konkretisht, mund të përmendim, projektet : si vijon: "Ndërtimi i një kopshti fëmijësh në Konispol", "Pajisja e shkollave me libra dhe printera", Krujë, "Konkursi i pianisteve të rinj" Tiranë, "Festimet për 7 Marsin në disa qytete të Shqipërisë si Shkodër, Kurbin Gramsh dhe Kuçovë" "Pajisja e laboratoreve informatike" Kavajë dhe Himarë etj. Në kuadër të projektit "Qyteti i Lexuesëve", është mbështetur pajisja me libra e bibliotekës së qytetit Krujë.

Një kontribut i rëndësishëm është dhënë për një sërë projektesh për mbrojtjen e mjedisit ku përmendim : projektin e bashkive Tiranë dhe Durrës "Blerja dhe mbjellja e pemëve", "Pastrimi i bregdetit përpara fillimit të sezonit turistik", "Vendosja e stolave në parkun e qytetit të Pogradecit". Një projekt i rëndësishëm në fushën sociale ka qënë "Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore" i zbatuar nga Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat.

Në fushën e artit dhe kulturës, janë mbështetur një sërë aktiviteteve artistiko-kulturore siç janë "Koncerti i Alban Skënderajt "Hapësira e një ëndërre"", "Festivali i 13 muzikës së Dhomës në Durrës", "Pianodrom-Festivali Ndërkombëtar i Pianos" "Balkan Jazz Festival", si dhe një sërë aktiviteteve të tjera kulturore të zhvilluara në qytete të ndryshme të vendit.

Raiffeisen Invest sha, në bashkëpunim me Raiffeisen Bank sha, mbeten të angazhuara të japin kontributin e tyre të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social -kulturore të vendit.










**BERAT**  
Festivali MultiKulturor



Edicioni V

# SHPAT DEDA

Më 21 korrik 2018 / Ora 21:30  
Oborri i Teqesë së Helvetive



# Edukimi financiar dhe transparenca ndaj publikut

Raiffeisen Invest sh.a. e konsideron edukimin financiar si një nga mekanizmat kryesorë që ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e tregut të kapitalit në tërësi dhe atij të fondeve të investimit e pensione në veçanti. Njohja e mirë e këtyre të fundit stimulon ofertimin e një game sa më të gjerë produktesh financiare, në përputhje me horizontin e investimit dhe profilin e rrezikut të investitorëve dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Edukimi financiar është një nga objektivat tanë strategjike që deri më sot është realizuar nëpërmjet botimeve me karakter informues dhe edukativ mbi fondet, zhvillimit të eventeve për investitorët si dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të pasur një nivel sa më të lartë transparence në çdo komunikim verbal apo të shkruar me investitorët. Ne besojmë se transparenca maksimale ndikon në rritjen e edukimit financiar dhe së bashku përbëjnë një komponent të rritjes së besimit të investitorëve në treg dhe në institucionet financiare - si aktorë të këtij tregu - duke inkurajuar pjesëmarrjen në të.

Në vitin 2018, Raiffeisen Invest sh.a mbështeti Konferencën Kombëtare të organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me titull "Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar". Qëllimi i saj ishte, rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit financiar me fokus kryesor studentët, të cilët u përfaqësuan me punime të ndryshme, për të nxitur diskutimin mbi zhvillimet e sotme më të rëndësishme në tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së në lidhje me problemet dhe sfidat e transformimit të këtyre tregjeve, dhe rëndësinë që edukimi financiar ka për zhvillimin e tyre.

Përveç aktorëve të tregut, pjesëmarrës në Konferencë ishin edhe ekspertë të huaj si dhe drejtues të institucioneve të sistemit arsimor në vend. Te gjithë pjesëmarrësit evidentuan rëndësinë e edukimit financiar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, si dhe zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare jobankare.

Në përfundim të Konferencës, u shpërndanë një sërë çmimesh për punimet më të mira.

Çmimet lidheshin me kontrata punësimi në shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje, mundësinë e intershipeve apo dhurimin e pajisjeve dixhitale për studentët.



# Raport i Menaxherëve të Fondeve

## Performanca e Fondeve në 31 Dhjetor 2018

Kthimi neto nga investimi

	Raiffeisen Prestigj	*Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Pension
<b>1 vit</b> (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2017 - 31.12.2018)	4.24%		-1.63%	5.47%
<b>3 vjet</b> (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2015 - 31.12.2018)	5.06%		1.63%	6.09%
<b>5 vjet</b> (kthimi në bazë vjetore periudha 31.12.2013 - 31.12.2018)	5.44%		2.10%	6.21%
<b>Që nga krijimi i fondit</b> (kthim me bazë vjetore)	6.06%	5.56%	2.32%	7.04%

Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

\*Fondi Raiffeisen Vizion u themelua më datë 30 Korrik 2018, me aprovimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 143. Periudha e ofertës fillestare filloi më 20 Gusht 2018 dhe përfundoi më 03 Shtator 2018 me çmimin e kuotës 1,000 Lekë.

Çmimi i Kuotës së Fondeve për 3 vitet e fundit

	Raiffeisen Prestigj	Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Pension
<b>Më 31.12.2018</b>	1,495.6624	1,017.8090	115.0323	1,724.4257
<b>Më 31.12.2017</b>	1,434.8851		116.9382	1,634.9663
<b>Më 31.12.2016</b>	1,381.4541		113.8404	1,544.4451

## Tarifat e Fondeve

	Raiffeisen Prestigj	Raiffeisen Vizion	Raiffeisen Invest Euro	Raiffeisen Pension
<b>Tarifa e Administrimit në bazë vjetore</b>	1.25%	1.25%	1.50%	1.50%



# Zhvillimet Ekonomike

## Tregu financiar shqiptar

Gjatë vitit 2018 aktiviteti i fondeve të Raiffeisen Invest u zhvillua në një mjedis ekonomik relativisht sfidues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm financiar, ku normat e interesit të titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare vijuan të jenë në nivele të ulëta.

Në pjesën e parë të vitit, yield-et në ankandet e tregut primar të titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare treguan rritje të lehtë për të gjitha maturitetet, ndërsa në pjesën e dytë të vitit treguan një rënie të ndjeshme sidomos për maturitetet afatgjatë. Kjo rënie erdhi si pasojë e uljes së normës bazë repo me 25 pikë bazë nga ana e Bankës Qendrore në javën e parë të muajit Qershor, duke shënuar nivelin më të ulët historik në 1.00 përqind, si edhe tepricës së likuiditetit në tregun vendas. Sistemi bankar vijoi të karakterizohet nga norma të ulëta të interesit për depozitat në Lekë dhe Euro.

Nga ana tjetër Qeveria Shqiptare, Banka e Shqipërisë dhe pjesëmarresit e tregut të titujve të Qeverisë shtuan përpjekjet për zhvillimin e tregut sekondar të titujve dhe për një periudhë 6 mujore u vu në zbatim një projekt pilot për organizimin e ankandit të Obligacionit Reference (Benchmark) 5 vjeçar. Të gjithë ofertuesit u paraqitën në ankand nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut (market makers), të përcaktuar nga emetuesi, Ministria e Financave.

Monedha vendase është vlerësuar ndjeshëm kundrejt monedhave të vendeve kryesore partnere tregtare dhe sidomos monedhës Euro. Kështu në 31 Dhjetor të vitit 2018, një Euro është këmbyer me 123.42 lekë, kundrejt nivelit 132.95 në 31 Dhjetor 2017 – rreth 7.2% më lirë se vitin e kaluar.

Inflacioni vjetor rezultoi mesatarisht në nivelin prej 2.0% në vitin 2018, pothuajse në të njëjtin nivel me atë të vitit paraardhës.

Vlerësimi i agjencive të rating për borxhin e Qeverisë Shqiptare qëndroi i pandryshuar në nivelin B1 nga Moody's dhe B+ nga "Standard & Poors" me një parashikim të qendrueshëm.

Qeveria Shqiptare emtoi Eurobondin e dytë në tregjet ndërkombetare me vlerën 500 milionë euro në Tetor 2018 me maturitet 7 vjet dhe normë interesi 3.50% dhe nga ana tjetër bleu mbrapsht pjesë të Eurobondit të vjetër me maturim në Nentor 2020 për vlerën 200 milionë Euro. Në këtë mënyrë Qeveria nuk zhvilloi emetime në monedhën euro në tregun vendas dhe maturoi obligacionet 2 vjeçare në euro. Sipas të dhënave të qeverisë borxhi publik vlerësohet të jetë zvogëluar në nivelin e afro 68% e GDP në fund të vitit 2018.

## Tregu vendas i Fondeve të Investimit

Gjatë vitit 2018, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre 5 fonde investimi, nga të cilat 3 nën administrimin e Raiffeisen Invest sh.a. Kështu gjatë vitit 2018 u shtua numri i fondeve të investimit nga 3 në 5 dhe për pasojë edhe alternativat për të investuar për publikun shqiptar.

Pavarësisht shtimit në numër të fondeve të investimit, sipas të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2018, vlera neto totale e aseteve të fondeve të investimit pësoi tkurrje me 9 për qind. Për këtë periudhë, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 6.6 miliardë lekë, me një rënie prej 6.6 miliardë lekë, krahasuar me vitin 2017.

Raiffeisen Invest sh.a. vijon të dominojë këtë treg duke zotëruar 96.92 përqind të tregut për sa i takon nivelit të aseteve: 72 përqind fondi Prestigj, 15.60 përqind fondi Euro dhe 9.26 përqind fondi Vizion.

Ky treg vijon të dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 61.25% të aseteve të fondeve. Krahas vlerës së aseteve, rënie ka pësuar edhe numri i investitoreve që kanë zgjedhur këtë formë investimi. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare konstaton se gjatë vitit 2018, numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit arriti në 29,420 duke u pësuar rënie me 6% krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2018, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare finalizoi një projekt të rëndësishëm me bashkëpunim të ekspertëve të huaj, me qëllim përmirësimin e kuadrit mbikëqyrës dhe rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të fondeve të investimeve në përputhje me parimet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Miratimi i Ligjit të rishikuar "Për sipermarrjet e investimeve kolektive" gjatë vitit 2019 do të hapë opsione për lloje të tjera të fondeve dhe zgjerim potencial të tregut.

## Tregjet financiare ndërkombëtare

Tregjet financiare ndërkombëtare të obligacioneve u karakterizuan nga një rënie e përgjithshme në vlerë në fillim të vitit 2018 sepse treguesit e mirë ekonomikë për Eurozonën nxitën pritshmëritë për rritje të normave të interesit dhe për faktin se Banka Qendrore Europiane do të ndalojë stimujt ekonomikë siç është programin e blerjes së obligacioneve në Shtator 2018. Në Mars të 2018 SHBA deklaroi vendosjen e tarifave të reja të importit mbi çelikun dhe aluminin në vlerën përkatësisht 25 për qind dhe 10 për qind.

Situata gjeopolitike mbizotëroi ecurinë e tregjeve financiare përgjatë të gjithë periudhës Prill – Maj 2018, duke filluar me sanksionet e SHBA ndaj kompanive ruse, konfliktin tregtar mes Kinës dhe SHBA e duke përfunduar me sulmet ajrore nga vendet perëndimore (SHBA, France, Mbretëri e Bashkuar) kundër Sirisë. Raundi i fundit i sanksioneve të Shteteve të Bashkuara pa një rritje të ashpërsisë, duke shenjestruar disa nga kompanitë më të mëdha ruse.

Frika mbi stabilitetin politik në Itali goditi tregjet gjatë muajit Maj teksa investitorët patën prospektin e një koalicioni populist në Romë ose të zgjedhjeve të reja, te cilat do të ishin praktikisht një referendum mbi zonën Euro.

Normat e interesit në SHBA ndoqën një trend rritës përgjatë gjithë vitit 2018 dhe Rezerva Federale rriti normën e interesit 4 herë përgjatë vitit duke e çuar në intervalin 2.25% - 2.50%, niveli më i lartë që nga pranvera e 2008-es. Rezerva Federale la të kuptohet se gjatë vitit 2019 do të ketë edhe 2 rritje të mëtejshme të normës bazë. Rezerva Federale vijoi me politikën monetare shtrënguese në kuadër të të dhënave shumë të mira ekonomike të SHBA, me papunesinë në nivelet më të ultë në disa dekada, ritmin e rritjes së rrogave më të lartë në 9 vitet e fundit dhe parashikimet për një rritje ekonomike për 3-mujorin e fundit prej 4% në bazë vjetore.

Vlerat e aksioneve në nivel global pësuan rritje mes rigjenerimit ekonomik, rritjes së të ardhurave të korporatave nga fillimi i vitit deri në muajin Shtator 2018.

Eurobondi Shqiptar pësoi një zhvlerësim të ndjeshëm në Maj të 2018-s duke qenë se pritej emetimi i një Eurobondi të ri para Tetorit 2018 (për një shumë maksimale prej EUR 500 milionë) dhe maturitet 5 – 10 vjet.

Në gjysmën e parë të muajit Qershor, tregjet ndërkombëtare të obligacioneve u karakterizuan nga një performancë e mirë, sidomos pas deklaratës së Bankës Qendrore Europiane se norma bazë e interesit nuk do të pësojë rritje deri para verës 2019. BQE vendosi të zgjasë programin e saj të blerjes së obligacioneve deri në Dhjetor 2018, duke përgjysmuar shumën e blerjeve mujore nga 30 bilionë euro në 15 bilionë euro. Gjatë verës tregjet financiare i lëvizën pritshmëritë për rritjen e parë të normave për në fund të vitit 2019.

Ndërkohë, drejt fundit të muajit Tetor, aksionet në tregjet ndërkombëtare pësuan rënie të ndjeshme, mes frikës se rritja ekonomike globale dhe fitimet e korporatave ndërkombëtare kishin arritur pikun e tyre përgjatë ciklit ekonomik e tashmë do të fillonin rënien, frikës për rritjen e normave dhe pasigurisë së shtuar prej rreziqeve gjeopolitike. Shifrat dekurajuese të rezultateve financiare të publikuara nga disa nga kompanitë më të mëdha të teknologjisë ndezën një shitje në masë të aksioneve ndërkombëtare, duke shtuar frikën në tregje se trend-it më të gjatë të rritjes së aksioneve në histori i kishte ardhur fundi.

Situata e Brexit mbeti gjithashtu ende e paqartë, teksa kryeministrja britanike Theresa May po haste vështirësi për të arritur një marrëveshje jo vetëm me liderët Europiane, por edhe me kolegët e saj brenda Partisë Konservatore.

Qeveria Amerikane u mbyll pjesërisht në 22 Dhjetor si pasojë e konfliktit të Republikanëve dhe Demokratëve në lidhje me financimin prej 5.7 miliardë dollarë të murit që Presidenti amerikan kërkon të ndërtojë mes Meksikës e SHBA. Pasiguria që lindi nga mbyllja e qeverisë rriti luhatshmërinë në tregjet e aksioneve në SHBA. Indekset kryesore të aksioneve si S&P500 dhe Dow Jones e mbyllën 2018-en me humbje prej përkatësisht 6.2% dhe 5.6%. Investitorët shitën aksionet botërore në masë mes frikës për ngadalësim të ekonomisë dhe negociatave tregtare mes Kinës dhe SHBA.

Megjithëse gjatë vitit 2018 ka dominuar një mjedis financiar me luhatshmëri të lartë në tregjet ndërkombëtare të obligacioneve, Raiffeisen Invest u përpoq të kufizojë në maksimum efektin negativ të rritjes së normave të interesit të obligacioneve në euro për Fondin në Euro, duke ulur kohëzgjatjen mesatare të portofolit të investimit dhe duke zvogëluar gradualisht ekspozimin në Eurobondin e vjetër të Qeverisë Shqiptare, i cili pësoi rënie të ndjeshme gjatë vitit 2018.

Për fondet në Lekë Raiffeisen Invest arriti të sigurojë performancë të kënaqshme, megjithëse normat e interesit ishin në nivele të ulëta.

# Fondi Raiffeisen Vizion

Gjatë vitit 2018 Raiffeisen Invest sh.a lançoi suksesshëm fondin e tretë të investimit Raiffeisen Vizion, duke ju ofruar investitorëve shqiptarë edhe një mundësi tjetër investimi në monedhën Lekë, me qëllim diversifikimin e portofolit të tyre financiar nëpërmjet investimeve më afatgjata.

Fondi Raiffeisen Vizion u themelua më datë 30 Korrik 2018, me aprovimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe është krijuar për një afat të pacaktuar. Periudha e ofertës fillestare filloi më 20 Gusht 2018 dhe përfundoi më 03 Shtator 2018.

Objekti i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi Vizion aplikon një periudhë minimale qëndrimi në fond prej 2 vitesh. Çdo shlyerje përpara përbushjes së periudhës 2-vjet, do të jetë subjekt i një tarife dalëse prej 2 përqind e vlerës së kuotave të shlyera.

Horizonti i rekomanduar i qëndrimit në fond është të paktën 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe në mënyrë që të përbushet objektivi i performancës së fondit.

## Politika e Investimit

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon të investojë të paktën 50 – 80 përqind të asetëve në obligacione afatgjatë të Qeverisë Shqiptare.

Gjatë vitit 2018 vlera neto e asetëve të fondit Vizion është rritur kënaqshëm duke arritur në 6.12 miliardë Lekë ose 49.58 milionë Euro në datën 31 Dhjetor 2018, ndërsa numri i anëtarëve në fond është 2,092.

Në 31 Dhjetor 2018, struktura e portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	16.02
Obligacione Thesari	51.16
Depozita afatshkurtëra / Llogari rrjedhese	29.52
Marrëveshje të Anasjellta të Riblerjes	3.31

Investimet e Fondit Vizion janë kryer kryesisht në obligacione thesari afatgjatë si dhe në bono thesari 12-mujore. Portofoli i investimeve nuk është kompletuar ende në fund të vitit 2018, duke qenë se ankandet e obligacioneve afatgjatë zhvillohen çdo 3 muaj dhe ai është ende duke u strukturuar duke marrë parasysh faktin se fondi ka vetëm 5 muaj që nga periudha e lançimit në Gusht 2018.

Për këtë arsye, ende rreth 33 përqind e portofolit të investimeve është e mbajtur në llogari rrjedhëse, në depozita afatshkurtra apo transaksione të Anasjellta të Riblerjes dhe kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) është në nivelin 2.75 në datë 31 Dhjetor 2018.

## Performanca e Fondit

Çmimi i kuotës së fondit Vizion është rritur me 1.78 përqind që nga fundi i periudhës së ofertës fillestare në 3 Shtator 2018 deri në datë 31 Dhjetor 2018.

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2018 është 5.56 përqind.

Trendi rritës i atribuohet investimeve në obligacione të Qeverisë Shqiptare, kryesisht me maturitet afatgjatë, si dhe rënies së normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare, që kanë impaktuar pozitivisht portofolin ekzistues të fondit. Paraqitja grafike e ecurisë së Fondit Vizion që nga lançimi në Shtator 2018 deri në 31 Dhjetor 2018

Ulja e ndjeshme e normave të interesit - kryesisht për obligacionet afatgjata, sidomos gjatë 3 muajve të fundit të vitit 2018, ka ndikuar në një rivlerësim në rritje të portofolit ekzistues duke shkaktuar rritje të mëtejshme të performancës së fondit.

## Strategjia e investimit gjatë vitit 2019

Fondi synon të ruajë një shpërndarje efikase të asetëve në instrumente të tilla financiarë si bono, obligacione, cash, depozita dhe marrëveshje të anasjellta të riblerjes (transaksione Reverse Repo).

Pritshmëritë janë që normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare të vijojnë të kenë një trend rënës gjatë vitit 2019, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit. Por normat e interesit mund të rriten për shkaqe të tilla siç janë zgjedhjet lokale në Qershor 2019 dhe rritjes së ofertës së Qeverisë për borxhin vendas ose për shkak të faktorëve të tjerë sezonalë.

Për të përmbushur objektivin e investimit dhe për të maksimizuar rritjen reale afatgjatë të asetëve të fondit, strategjia e investimit do të jetë kryesisht e përqëndruar në investime afatgjatë duke siguruar edhe rritjen e maturimit mesatar të portofolit (duration). Gjithashtu do të synohet zbatimi i politikave të brendshme për një menaxhim sa më efikas të likuiditetit. Fondi do të synojë të rrisë kohëzgjatjen mesatare të portofolit të investimit (duration) në nivelin e 4 – 4.50 përmes investimeve në obligacione afatgjatë 5 – 10 vjet të emtuara nga Qeveria Shqiptare.

Portofoli i investimit do të vazhdojë të jetë i ekspozuar ndaj luhatshmërisë së normave të interesit të titujve të borxhit të emtuara nga Qeveria Shqiptare.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

Fondi Raiffeisen Vizion

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari Reference 5 vjet – Mat 19.07.2023	17.4%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 03.04.2028	10.4%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 06.07.2028	7.6%
Bono Thesari 12 Muaj – Mat 24.10.2019	6.3%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 11.06.2025	5.1%
Bono Thesari 12 Muaj – Mat 05.09.2019	4.9%
Bono Thesari 12 Muaj – Mat 05.12.2019	4.8%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.06.2022	3.8%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 23.10.2025	3.4%
Obligacion Thesari 2 vjet – Mat 18.09.2020	1.7%

# Fondi Raiffeisen Prestigj

Fondi Raiffeisen Prestigj është i denominuar në monedhën lokale LEKË. Objektivi i fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar njëkohësisht ruajtjen e kapitalit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në shërbim të arritjes së objektivit.

Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në bono thesari dhe obligacione thesari të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

## Politika e Investimit

Gjatë vitit 2018, fondi Prestigj vijoi të kryejë investimet në tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare, kryesisht me maturitet afatshkurtër deri në afatmesëm.

Shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë në krahasim me normën mesatare të interesit të ofruar në sistemin bankar për depozitat me afat 12 muaj, por në të njëjtën kohë edhe menaxhimin sa më efikas të rrezikut të likuiditetit dhe respektimin e raporteve të likuiditetit. Për këtë të fundit, është rritur pesha e aseteve me maturim afatshkurtër, kryesisht bono thesari dhe depozita afatshkurtëra dhe është ulur kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) në nivelin 1.69 në datë 31 Dhjetor 2018 nga 1.82 në vitin e mëparshëm.

Likuiditeti i tepërt është investuar si depozitë afatshkurtër ose duke përdorur marrëveshjet e riblerjes me bankat lokale. Në 31 Dhjetor 2018, struktura e portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Instrumenti	% e Aseteve
Bono Thesari	19.10
Obligacione Thesari	68.67
Depozita afatshkurtëra / Llogari rrjedhese	9.66
Marrëveshje të Anasjellta të Riblerjes	2.58

Vlera neto e aseteve të fondit arriti në 47.62 miliardë Lekë / 386 milionë Euro në Dhjetor të 2018, duke shënuar një rënie në krahasim me vitin e mëparshëm. Numri i anëtarëve në fond ishte 23,051 në datën 31 Dhjetor 2018.


Duke patur parasysh zhvillimet ekonomike dhe të tregut në tërësi, 2 ishin faktorët kryesorë, të cilët kanë ndikuar në rënien e nivelit të aseteve të fondit Prestigj gjatë vitit 2018:

- Rënia e normave të interesit të instrumentave financiarë në tërësi në tregun shqiptar, përfshirë këtu edhe interesat e titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare në të cilat fondi Prestigj investon, kanë bërë që fondi të gjenerojë performancë më të ulët, sidomos në pjesën e parë të vitit 2018 duke rritur nivelin e daljeve nga fondi.
- Prezantimi i fondit Vizion në pjesën e dytë të vitit dhe vendimmarrja e një pjese të investitorëve për të zhvendosur tërësisht apo një pjesë të investimeve të tyre në Fondin Raiffeisen Vizion, me qëllim diversifikimin e portofolit të tyre të investimit dhe mundësisë për të patur një kthim potencial më të lartë.

# Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2018 është 4.24 përqind, duke pësuar rritje në raport me vitin e shkuar.

Fondi Raiffeisen Prestigj performanca vjetore



Megjithëse gjatë vitit 2018 ka dominuar një mjedis financiar me norma shumë të ulëta interesi në tregun vendas, fondi Raiffeisen Prestigj arriti të sigurojë performancë shumë të kënaqshme dhe çmimi i kuotës ka ndjekur një trend rritës gjatë vitit.

Fondi Prestigj e nisi vitin 2018 me rënie mujore prej 0.22 përqind në muajin Janar 2018, duke shënuar edhe rënien e tij më të lartë historike në datë 8 janar 2018 prej 0.46 përqind, e cila erdhi si pasojë e rritjes së menjëhershme të normës së interesit në treg të obligacionit 3 vjeçar të Qeverisë Shqiptare, e cila pësoi një rritje të konsiderueshme prej 1.05%. Më pas fondi rikuperoi rënien përgjatë muajit Shkurt dhe pati një rritje të qëndrueshme gjatë vitit, për ta përfunduar me një rritje të lartë mujore prej 0.65% në muajin Dhjetor 2018.

Gjatë vitit 2018, normat e interesit të obligacioneve të Qeverisë Shqiptare kanë mbetur në nivele të ulëta dhe për rrjedhojë, investimet e fondit janë kryer me norma më të ulëta interesi, por portofoli i investimeve në tërësi është vlerësuar pozitivisht, për shkak të rënies së normave të interesit të titujve të Qeverisë, kryesisht gjatë pjesës së dytë të vitit 2018.

## Strategjia e investimit gjatë vitit 2019

Ffondi synon të ruajë një shpërndarje efikase të aseteve në instrumente të tilla financiarë si bono, obligacione, cash, depozita dhe marrëveshje të anasjellta të riblerjes (transaksione Reverse Repo).

Pritshmëritë janë që normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare të vijojnë të kenë një trend rënës gjatë vitit 2019, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit. Por normat e interesit mund të rriten për shkaqe të tilla siç janë zgjedhjet lokale në Qershor 2019 dhe rritjes së ofertës së Qeverisë për borxhin vendas ose për shkak të faktorëve të tjerë sezonalë.

Strategjia e investimit të fondit do të jetë kryesisht e përqëndruar në investime afatshkurtra deri në afatmesëm, duke synuar të ruhet kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (duration) e qëndrueshme në nivelin 1.5 - 1.8.

Portofoli i investimit do të vazhdojë të jetë i ekspozuar ndaj luhatshmërisë së normave të interesit të titujve të borxhit të emetuara nga Qeveria Shqiptare, por si rezultat i kohëzgjatjes mesatare të portofolit të investimit relativisht të ulët do të mund të kufizohet luhatshmëria në fond si rezultat i ndryshimit në normat e interesit të titujve.

Gjithashtu do të synohet zbatimi i politikave të brendshme për një menaxhim sa më efikas të likuiditetit. Ndërkohë do të vijojë aplikimi i shkallëzimit të maturimeve me qëllim për të siguruar një përfaqësim optimal të të gjithë kurbës së interesit të instrumenteve.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

Fondi Raiffeisen Prestigj

Instrumenti	% e Asetëve
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 29.10.2023	8.87%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 17.03.2021	5.11%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 20.09.2020	3.98%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 18.03.2020	3.21%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 10.02.2019	2.95%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 09.12.2021	2.74%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 20.09.2020	2.65%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.12.2020	2.64%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 08.08.2022	2.59%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 16.12.2020	2.40%

# Fondi Raiffeisen Invest Euro

Fondi Raiffeisen Invest Euro është i denominuar në monedhën Euro. Objektivi i fondit është t'i japë investitorit një kthim konkurrues, në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të aseteve duke mbrojtur kapitalin dhe ruajtur nivelin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara kryesisht në obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar, në obligacione të emetuara nga qeveri të vendeve të BE-së dhe korporata ndërkombëtare, në depozita bankare afatshkurtëra dhe në fonde investimi, të cilat gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve

## Politika e Investimit

Gjatë vitit 2018 është zbatuar një politikë investimi e kujdesshme duke ndërthurur manaxhimin e rreziqeve të tregut me shpërndarjen efektive të aseteve, me synimin për të ulur ndikimin e rrezikut që vinte nga rritja e normave të interesit në tregjet financiare të zonës euro. Portofoli i investimeve është përshtatur në përputhje me këtë objektiv, si dhe në përputhje me zhvillimet e tregut, bazuar në një përzgjedhje të kujdesshme të instrumenteve financiare.

Në tërësi shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim diversifikimin e portofolit, me qëllim reduktimin e rrezikut të tregut, kryesisht atë të normave të interesit, dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm. Kështu strategjia e investimeve ka qenë e fokusuar kryesisht në uljen e kohëzgjatjes mesatare të portofolit të investimit (duration) për të ulur ndikimin negativ nga rritja e normave të interesit të obligacioneve. Niveli i kohëzgjatjes mesatare është ulur gradualisht nga 3.22 në Dhjetor 2017 në 2.50 në fund të Shtator 2018.

Në muajin Tetor të 2018-s fondi Euro investoi në Eurobondin e ri me maturitet 7 vjet, të emetuar në monedhën euro nga Qeveria Shqiptare dhe zvogëloi gradualisht ekspozimin në Eurobondin e vjetër me maturim Nëntor 2020 të emetuar nga Qeveria Shqiptare, i cili pësoi rënie në performancë gjatë vitit 2018. Investimi në Eurobond-in e ri me maturitet 7 vjeçar rriti kohëzgjatjen mesatare të portofolit të investimit (duration), e cila rezultoi 3.06 në 31 Dhjetor 2018, por gjithësesi mbeti më e ulët se vitin e mëparshëm.

Në 31 Dhjetor 2018 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme :

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione të Qeverisë Shqiptare	36.56
Obligacione të Qeverive të huaja	8.74
Obligacione të Korporatave	20.09
Fonde të investimeve	25.87
Depozita / Llogari rrjedhëse	8.74

Gjatë vitit 2018, tregu ndërkombëtar i obligacioneve në Euro performoi negativisht, me rritje të normave të interesit. Gjithashtu Eurobondet e Qeverisë shqiptare, në të cilat fondi është i ekspozuar në mënyrë të ndjeshme kanë pësuar rritje në normat e interesit dhe rënie në vlerë gjatë vitit 2018. Kështu Eurobond i vjetër i emetuar në Nëntor të vitit 2015, e nisi vitin me yield 1.39% (çmim 112.20) dhe e përfundoi me yield 1.69% (çmim 107.40), ndërsa Eurobond i ri 7 vjeçar, i emetuar në Tetor 2018 me yield 3.55% arriti në 3.62% në fund të vitit.

Vlera neto e aseteve të fondit ishte 83.5 milionë Euro në 31 Dhjetor 2018, duke shënuar një rënie me 27 milionë Euro ose 24.5% në krahasim me vitin e shkuar. Numri i anëtarëve në fond në fund të 2018 ishte 3,505.

I tërë portofoli i investimeve është karakterizuar nga një luhatshmëri relativisht e lartë gjatë vitit 2018 dhe rënia në performancën e fondit ka ndikuar gjithashtu në rënie të nivelit të aseteve.




## Performanca e Fondit

Në një mjedis financiar të ndikuar nga pritshmëritë për rritje të normave të interesit në tregjet e obligacioneve në euro si pasojë e mbylljes së programit të blerjes së obligacioneve nga ana e Bankës Qendrore Europiane, daljes nga territori i inflacionit të ulët dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike, performanca e Fondit Euro rezultoi relativisht e luhatshme gjatë vitit 2018 dhe hyri në territor negativ në muajin Gusht 2018, për herë të parë që nga lançimi i fondit.

Fondi Euro e përfundoi vitin 2018 me kthim negativ 1.63 përqind në bazë vjetore.

Fondi Raiffeisen Invest Euro performanca vjetore



Viti 2018 u dominua nga rritja e pasigurisë në tregjet financiare dhe performanca negative e obligacioneve për shkak edhe të rreziqeve gjeopolitike në rritje si "lufta tregtare" e inicuar nga SHBA me vendosjen e tarifave të larta për importin e çelikut dhe aluminit, konfrontimet e SHBA me Korenë e Veriut dhe Iranin, dhe paqëndrueshmërisë politike për qeverinë e re në Itali. Rritja e normave të interesit uli çmimet e obligacioneve në tregjet ndërkombëtare në monedhen Euro.

Eurobondi Shqiptar me maturim Nëntor 2020 gjithashtu pësoi një zhvlerësim duke qenë se pritej emetimi i Eurobondit të ri gjatë vitit 2018 dhe si rrjedhojë fondi Euro pësoi humbjen më të lartë mujore prej 0.65 përqind në muajin Maj të 2018-s.

Përgjatë verës tregjet ndërkombëtare të obligacioneve ishin relativisht më të qeta dhe kjo u reflektua edhe në performancën e fondit Euro, e cila ishte relativisht e qëndrueshme.

Luhatshmëria u rikthye në tregjet financiare në fundin e vitit me rënie të lartë në tregun e obligacioneve dhe sidomos atë të aksioneve, teksa tregjet përgatiteshin për rritje të normave të interesit nga ana e Bankave Qendrore kryesore. Kështu Rezerva Federale Amerikane rriti në Dhjetor normën bazë për herë të katërt gjatë vitit dhe Banka Qendrore Europiane i dha fund në Dhjetor 2018 programit të stimulimit duke blerë obligacione në treg, program i cili filloi në vitet e krizës. Performanca negative u ndikua akoma më shumë nga paqartësitë në rritje mbi situatën e Brexit, nga intensifikimi i lartë i konfliktit tregtar të SHBA dhe Kinës dhe tensionet politike në Itali.

Të gjithë këta faktorë ndikuan edhe në performancën e investimeve në obligacionet në euro të fondit dhe në trendin rënës të tij gjatë 3 muajit të fundit të vitit 2018.

## Strategjia e investimit gjatë vitit 2019

Strategjia e Fondit gjatë 2019-ës do të synojë një shpërndarje sa më efektive të asetëve midis klasave të ndryshme, duke diversifikuar portofolin mbi bazë emetuesi dhe sektori të ekonomisë.

Viti 2018 u mbyll me rritje të normave të interesit në tregun e obligacioneve dhe pritshmëritë për gjallërimin e ekonomisë për zonën Euro dhe për rritje të normës së inflacionit mund të sjellin rritje të mëtejshme të normave të interesit në tregun e obligacioneve. Rritja e normave të interesit mund të ndikojë negativisht në portofolin ekzistues të fondit në Euro dhe në këto kushte 2019-a do të jetë vit tepër sfidues për të gjeneruar kthime të kënaqshme.

Nga ana tjetër janë rritur parashikimet për rreziqe të shtuara gjeopolitike, kryesisht ato të lidhura me marrëveshjen BE – Britani e madhe për çështjen Brexit apo politikën proteksioniste nga ana e SHBA, duke intensifikuar konfliktin tregtar me vendosjen e tarifave të larta tregtare me Kinën, vendet e BE-s, Kanadanë dhe Meksikën. Këto rreziqe politike mund të ndikojnë në të dhënat ekonomik të vendeve si Kinë, Gjermani, Britani apo SHBA dhe në rritjen ekonomike globale, duke ndikuar edhe në zhvendosjen e investitorëve drejt instrumentave më të sigurt siç janë obligacionet qeveritare dhe në politikat monetare lehtësuese të Bankave Qëndrore duke favorizuar normat e ulëta të interesave.

Tregjet financiare pritet të karakterizohen nga paqëndrueshmëri dhe të dominohen nga ndikimet e mundshme të zbatimit të politikave monetare nga ana e Bankave Qëndrore në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Bazuar në këto pritshmëri, portfoli i fondit do të menaxhohet me kujdes dhe në raport me lëvizjet e tregjeve financiare për të gjeneruar një performancë vjetore pozitive. Strategjia e investimit mbi bazën e kohëzgjatjes mesatare të portfolit të investimit (duration) do të jetë mjaft e rëndësishme në këtë mjedis, jo vetëm për sigurimin e performancës por edhe për menaxhimin e rrezikut të normave të interesit.

Në tregun vendas pritshmëritë për emetime në monedhen euro nga ana e Qeverisë Shqiptare janë shumë të ulëta, duke gene se u realizua emetimi i Eurobond-in prej 500 milionë euro në tregjet ndërkombëtare . Gjithësesi Fondi do të jetë aktiv në rast se do të zhvillohen ankande në Euro, duke synuar të kryejë investime me norma interesi të pranueshme për nivelin e rrezikut të ndërmarrë dhe natyrën e një tregu joaktiv për emetimet në Euro në tregun vendas.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e asetëve

### Fondi Raiffeisen Inveset Euro

Instrumenti	% e Aseteve
Eurobond 7 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Tetor 2025	15.46%
Eurobond 5 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Nëntor 2020	10.98%
Obligacion 2 vjet i Qeverisë Shqiptare – Maturim Gusht 2019	9.57%
Fond Investimi – Raiffeisen - Euro - Rendite	4.70%
Eurobond i Republikës së Malit të Zi - Maturim Mars 2021	4.27%
Fond Investimi – Raiffeisen 304 - Euro Corporates	3.42%
Fond Investimi – Raiffeisen – Europa – High Yield	3.41%
Eurobond i Republikës së Malit të Zi - Maturim Mars 2020	3.13%
Fond Investimi - Morgan Stanley Inv. - Euro Strategic	2.50%
Fond Investimi – Alliance Bernstein – European Income	2.48%

# Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen është i denominuar në monedhën Lekë dhe është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata.

Objekti i fondit është investimi i aseteve sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Vlera neto e aseteve të fondit arriti në Lekë 622.8 milione ose 5.05 milionë Euro në 31 Dhjetor 2018.

Gjatë vitit 2018, asetet e Fondit të Pensionit Vullnetar u rritën me 23% dhe shoqëria shtoi përpjekjet për të promovuar fondin e Pensionit në formën e planeve individuale dhe profesionale të pensionit.

Numri i anëtarëve në fond në fund të 2018 shënoi rritje prej 4% krahasuar me vitin paraardhës ose 111 anëtarë më shumë.

Gjatë vitit u zhvilluan seanca informuese me kompani dhe institucione financiare vendase, me qëllimin për të promovuar fondin e Pensionit në formën e planeve individuale dhe profesionale të pensionit vullnetar dhe për të shtuar pjesëmarrjen e punonjësve të këtyre kompanive apo institucioneve në një fond pensioni vullnetar.

Gjatë vitit 2018, në skemën profesionale të Fondit të pensionit vullnetar Raiffeisen u integruan kompani të reja, të cilat e vlerësojnë pozitivisht kontributin për pension për punonjësit e tyre duke e konsideruar një mënyrë incentivimi dhe motivimi, por dhe përbushje të përgjegjësisë sociale.

## Politika e Investimit

Gjatë vitit 2018 fondi i Pensionit investoi në obligacione afatgjatë me maturitet 5, 7 dhe 10 vjeçar, të emetuara nga Qeveria shqiptare në tregun vendas.

Shpërndarja e aseteve të fondit kishte për qëllim prodhimin e një marzhi fitimi sa më të lartë, objektiv i cili u arrit me sukses, megjithëse mjedisi financiar është dominuar nga norma interesi të ulëta.

Në 31 Dhjetor 2018 struktura e Portofolit të investimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:


Instrumenti	% e Aseteve
Obligacione Thesari	98.58
Llogari rrjedhëse	1.42

## Performanca e Fondit

Në bazë vjetore, kthimi për vitin 2018 është 5.47%, duke pësuar rënie në krahasim me vitin e mëparshëm.

Performanca e fondit të Pensionit ka rezultuar më e ulët krahasimisht më të njëjtën periudhë vitin e kaluar si rrjedhojë e nivelit të ulët të normave të interesit të obligacioneve afatgjata të Qeverisë Shqiptare.

## Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen - performanca vjetore



Në tërësi çmimi i kuotës së Fondit të Pensionit ka ndjekur një trend rritës përgjatë vitit. Në muajt e parë të vitit, gjatë periudhës Janar – Shkurt rritja e çmimit të kuotës së fondit është ngadalësuar si pasojë e efektit negativ që pati rritja e përkohshme e normave të interesit të disa obligacioneve në tregun vendas, duke ndikuar negativisht në performancën e investimeve të mëparshme të realizuara nga Fondi i Pensionit. Më pas në vazhdimësi rritja e fondit ka qenë e qëndrueshme.

Kthimi mesatar vjetor neto që nga momenti i lancimit të fondit deri në 31 Dhjetor 2018 është 7.04%.

Në datën 31 Dhjetor 2018 performanca e fondit është 6.21% (me bazë vjetore) për një periudhë 5 vjeçare. Në datën 31 Dhjetor 2018 performanca e fondit është 5.67% (me bazë vjetore) për një periudhë 2 vjeçare.

## Strategjia e zhvillimit të fondit gjatë vitit 2019

Për sa i përket investimeve, Fondi synon të ruajë balancën e duhur midis investimeve në obligacione afatgjatë me qëllimin për të gjeneruar rritjen e vlerës së aseteve dhe gjendjes së mjaftueshme të likuiditetit për të përballuar daljet nga fondi të investitorëve që plotësojnë kushtet për marrjen e fondit të pensionit vullnetar apo të atyre që kryejnë dalje të parakohshme nga fondi. Në fokus do të vazhdojnë të jenë investimet në obligacione afatgjatë duke patur parasysh edhe horizontin afatgjatë të investitorëve të fondit të pensionit vullnetar.

Pritshmëritë janë që Fondi i pensionit të vijojë të ketë rritje gjatë vitit 2019, si rezultat i kontributeve të qëndrueshme nga planet profesionale dhe një interesi të shtuar nga ana e publikut për fondet e pensionit.

Përditësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ me iniciativa për të stimuluar anëtarësimin në fondet e pensionit vullnetar do të jetë një faktor nxitës më shumë për të zhvilluar tregun e fondeve të pensionit vullnetar në Shqipëri.

## Top 10 - Investimet Kryesore si përqindje e aseteve

### Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Instrumenti	% e Aseteve
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 18.01.2026	7.43%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 06.07.2028	7.37%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 23.01.2025	5.73%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 09.12.2021	5.58%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 03.03.2024	3.80%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 11.06.2025	3.77%
Obligacion Thesari 5 vjet – Mat 19.07.2023	3.51%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 03.04.2028	3.29%
Obligacion Thesari 10 vjet – Mat 15.07.2026	3.10%
Obligacion Thesari 7 vjet – Mat 01.06.2024	2.74%

# Raport i Menaxherit të Rrezikut

## Tregues të Rrezikut

Fondi	Kohëzgjatja	Kohëzgjatja e modifikuar	Devijimi standard	*Treguesi sintetik i Rrezikut
Raiffeisen Prestigj	1.69	1.66	2.54%	Niveli 2
Raiffeisen Vizion	2.70	2.64	1.14%	Niveli 3
Raiffeisen Invest Euro	3.06	3.00	1.77%	Niveli 2
Raiffeisen Pension	4.28	4.14	1.16%	Niveli 1

\* Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1 deri në nivelin 7) duke u bazuar mbi luhatshmërinë historike të performancës së fondit.

Administrimi i Rrezikut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në Këshillin e Administrimit, Komitetin e Investimit dhe AMF respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të rrezikut. Gjatë vitit 2018, janë respektuar të gjitha limitet ligjore apo të brendshme.

Shumë nga treguesit kanë qenë stabël dhe fondet e investimit kanë patur rritje të nivelit të likuiditetit, në përputhje me politikat e brendshme dhe kërkesat rregullatore për manaxhimin e likuiditetit.

Janë përditësuar të gjitha metodologjitë dhe procedurat e manaxhimit të rrezikut, duke përfshirë kërkesat dhe rregulloret e reja të hartuara nga AMF apo grupi Raiffeisen.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe njohjes së investitorit ka vazhduar përmirësimi i kategorizimit të profilit të rrezikut të investitorëve. Kjo na ndihmon për të kryer një manaxhim më të drejtë të fondeve ekzistuese, por edhe për të ofruar fonde të përshtatshme për secilën kategori.

Për fondin Prestigj, gjatë vitit 2018, është vërejtur një ulje e duration të portofolit të investimit. Luhatshmëria e normave të titujve të qeverisë shqiptare ka sjellë një rritje të lehtë të devijimit standart dhe luhatshmërisë së kthimit. Megjithatë treguesi sintetik i rrezikut nuk ka ndryshuar dhe mbetet në nivelin 2. Kjo tregon që fondit Prestigj vazhdon të jete një fond me profil të ulët rreziku.

Fondi Vizion u lançua në Gusht 2018 dhe ka patur një luhatshmëri të lehtë, por duke qenë një fond me investime më afatgjatë, treguesi sintetik i rrezikut është vlerësuar në nivelin 3, bazuar mbi historikun e luhatshmërisë së normave të titujve qeverisë shqiptare.

Për fondin Euro, treguesit e rrezikut kanë qenë stabël. Falë diversifikimit të tij dhe një administrimi më dinamik, është arritur që luhatshmëria e tij të jetë më e ulët se ajo e tregjeve ndërkombëtare të obligacioneve.

Për fondin e Pensioneve Vullnetare, duke qenë se pjesa më e madhe e portofolit do të mbahet deri në maturim dhe vlerësohet me amortizim linear, luhatshmëria e kthimit është tepër e ulët. Si rezultat, treguesi sintetik i rrezikut është në nivelin 1.

---

# Përmbajtje

**RAIFFEISEN INVEST – SHOQËRI ADMINISTRUESE  
E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE  
TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE SH.A.**

Pasqyrat Financiare  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(me raportin e Audituesve të pavarur)

---

<b>Raporti i Audituesve të pavarur</b>	32
<b>Pasqyrat Financiare</b>	34
Pasqyra e pozicionit financiar	34
Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	35
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	36
Pasqyra e flukseve monetare	37
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	38

# Raporti i Audituesit të Pavarur

**Për aksionarët e Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënime për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 janë audituar nga një auditues tjetër që ka shprehur një opinion të pa modifikuar mbi ato pasqyra financiare më 30 mars 2018.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.



Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Fatos Beqja

Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk

Blvd "Dëshmorët e Kombit"

Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13

Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 29 mars 2019

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Aktivët</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8	372,247,116	398,953,641
Llogari të arkëtueshme nga Fondet	9	72,681,051	81,509,299
Invetime me kosto të amortizuar	10	5,102,500	20,152,000
Aktive afatgjata materiale	11	10,347,239	11,996,259
Aktive afatgjata jomateriale	12	7,278,162	6,377,629
Parapagime ndaj punonjësve		327,568	400,609
Tatim fitimi i parapaguar		9,260,280	-
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>477,243,916</b>	<b>519,389,437</b>
<b>Detyrimet</b>			
Tatim fitimi i pagueshëm		-	5,391,342
Detyrime të tjera	13	16,307,446	15,962,073
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>16,307,446</b>	<b>21,353,415</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksioner	14	90,000,000	90,000,000
Rezerva ligjore	15	9,000,000	9,000,000
Fitime të mbartura		361,936,470	399,036,022
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>460,936,470</b>	<b>498,036,022</b>
<b>Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve</b>		<b>477,243,916</b>	<b>519,389,437</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli i Administrimit të Raiffesien INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. më 29 mars 2019.



Administrator i Përgjithshëm  
Edlira KONINI

Zv. Administratore e Përgjithshme  
Alketa EMINI

## Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Të ardhurat</b>			
Tarifa të administrimit të Fondeve	14	864,192,775	929,812,523
Të ardhura interesi	15	1,565,664	1,631,863
Tarifa të largimit nga fondi		1,619,496	1,151,424
Të ardhura te tjera		125,125	1,722,556
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>867,503,060</b>	<b>934,318,366</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për personelin	18	(43,775,141)	(42,138,402)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11, 12	(4,425,768)	(5,761,904)
Shpenzime të përgjithshme administrative	19	(562,590,019)	(568,840,168)
Shpenzime të tjera		-	(228,464)
<b>Fitimi operativ para kostove financiare</b>		<b>256,712,132</b>	<b>317,349,428</b>
<b>Humbje neto nga kursi i këmbimit</b>		<b>(1,128,723)</b>	<b>(716,888)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>255,583,409</b>	<b>316,632,540</b>
Tatim mbi fitimin	20	(102,012,335)	(112,356,779)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>153,571,074</b>	<b>204,275,759</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>153,571,074</b>	<b>204,275,759</b>

Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>194,760,263</b>	<b>293,760,263</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>				
Fitimi i vitit	-	-	204,275,759	<b>204,275,759</b>
Të ardhura gjithëpërfshirëse				
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>204,275,759</b>	<b>204,275,759</b>
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>				
Dividendë	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>399,036,022</b>	<b>498,036,022</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>399,036,022</b>	<b>498,036,022</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>				
Fitimi i vitit	-	-	153,571,074	153,571,074
Të ardhura gjithëpërfshirëse			-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>153,571,074</b>	<b>153,571,074</b>
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>				
Dividendë	-	-	(190,670,626)	(190,670,626)
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(190,670,626)</b>	<b>(190,670,626)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>361,936,470</b>	<b>460,936,470</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Flukse monetare nga aktiviteti operativ</b>			
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>153,571,074</b>	<b>204,275,759</b>
<b>Rregullime për:</b>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	11, 12	4,425,768	5,761,904
Të ardhura nga interesi	17	(1,565,664)	(1,631,863)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	102,012,335	112,356,779
		<b>258,443,513</b>	<b>320,762,579</b>
<b>Ndryshime në:</b>			
Të arkëtueshme nga fondet		8,828,248	(7,451,081)
Aktive të tjera		73,041	(265,239)
Detyrime të tjera		345,373	(9,782,565)
<b>Mjete monetare nga aktiviteti operativ</b>		<b>267,690,175</b>	<b>303,263,694</b>
Interes i arkëtuar		1,615,164	1,631,863
Tatimi mbi fitimin i paguar		(116,663,957)	(113,034,793)
<b>Para neto nga aktiviteti operativ</b>		<b>152,641,382</b>	<b>191,860,764</b>
<b>Flukse monetare nga aktiviteti investues</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(1,012,562)	(2,577,143)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		-	4,975,294
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale		(2,664,719)	(162,042)
Të hyra nga maturimi i aktiveve financiare		15,000,000	-
<b>Para neto nga aktiviteti investues</b>		<b>11,322,719</b>	<b>2,236,109</b>
<b>Flukse monetare nga aktiviteti financues</b>			
Dividendë të paguar		(190,670,626)	-
<b>Para neto përdorur në aktivitetin financues</b>		<b>(190,670,626)</b>	<b>-</b>
(Pakësimi)/rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre gjatë vitit		(26,706,525)	194,096,873
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar</b>		<b>398,953,641</b>	<b>204,856,758</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>		<b>372,247,116</b>	<b>398,953,641</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 38 deri në 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. HYRJE

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere shqiptare me qendër në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë nga Gjykata e Tiranës me vendimin nr. 33825, i dates 18 korrik 2005. Zyrat qëndrore ndodhen në Bulevardin "Bajram Curri", ETC, Kati i 10-të, Tiranë.

Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") më 7 korrik 2005 (License Nr. 2) për të vepruar si shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Gjithashtu, Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011 (License Nr. 1) për të vepruar si shoqëri administruese e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Aktiviteti i Shoqërisë mbikqyret nga AMF, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03 korrik 2006 "Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare", ligjit nr.10197, datë 10 Dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligjit nr.10198, datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria ka një marrëveshje për shërbime depozituese për fondin e pensioneve me Bankën e Parë të Investimeve të Shqipërisë, me seli në Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake 2, Kati 14, Tirana ("Banka Kujdestare"). Banka Kujdestare është e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit (vendimi nr.13, datë 10.03.2010). Banka Kujdestare është gjithashtu e licencuar nga AMF për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit (vendimi nr. 80, datë 30 gusht 2010) dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive (vendimi nr.1, datë 13.12.2011).

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- menaxhimi i fondit të pensionit vullnetar nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve bazuar në Ligjin nr. 10197, të datës 10 Dhjetor 2009 "Mbi fondet e pensionit vullnetar", si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së rrezikut (diversifikimit), si qëllim për të siguruar përfitime pensioni për personat që janë anëtarë të fondit. Shoqëria mund të sigurojë gjithashtu kryerjen e pagesave të pensionit;
- të themeloje dhe/ose të menaxhojë Sipërmarrje të Investimeve Kolektive bazuar në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive";
- të përformojë aktivitete të tjera siç përshkruhet në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrje të investimeve kolektive".

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese për fondet e mëposhtme:

- Fondi me Kontribute të Përcaktuara "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen" i aprovuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 18 tetor 2010;
- "Raiffeisen Prestigj"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011;
- "Raiffeisen Vision"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 30 korrik 2018
- "Raiffeisen Invest Euro"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 26 shtator 2012.

Znj. Donalda GJORGA

Kryetare e Këshillit të Administrimit

Znj. Peter ZILINEK

Nën kryetar i Këshillit të Administrimit

Znj. Vilma BAÇE

Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Alda SHEHU

Anëtare e Këshillit të Administrimit

Z. Joan CANAJ

Anëtar i Këshillit të Administrimit

Znj. Edlira KONINI

Anëtare e Këshillit të Administrimit

Znj. Alketa EMINI

Anëtare e Këshillit të Administrimit

Administratorët janë:

Znj. Edlira Konini

Administrator i Përgjithshëm

Znj Alketa Emini

Zv/Administratore e Përgjithshme

## 2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto janë pasqyrat e para financiare vjetore në të cilat aplikohen SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël janë të përshkruara në Shënimin 5.

## 3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqipëtar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

## 4. BAZAT E MATJEVE

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

## 5. VLERËSIMET DHE GJYKIME KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet.

Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

### A. Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të perfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimin 6(b) – njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat njihen përgjatë kohës apo në një moment të caktuar në kohë.

### B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 21(i) – zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen;
- Shënimi 22: njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: vlerësimet kryesore për mundësinë dhe sasinë flukseve dalese të burimeve

## 6. NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria ka nisur zbatimin e SNRF 15 (shih A) dhe SNRF 9 (shih B) nga 1 janar 2018. Një numër standardesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janar 2018 por nuk kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Për shkak të metodave të tranzicionit të zgjedhura nga Shoqëria për të aplikuar këto standarde, informacioni krahasues në këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja. Zbatimi fillestar i

## 6. NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

këtyre standardeve nuk ka rezultuar në rregullime dhe është limituar në kërkesa për informacione shpjeguese shtesë. Përveç ndryshimeve me poshte, shoqëria ka aplikuar politikat kontabel ne menyre konsistente sic eshte shpjeguar ne Shenimin 7, ne te gjitha periudhat e prezantura ne keto pasqyra financiare.

### A. SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 vendos një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur njihen të ardhurat. Ai zëvendësoi SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe interpretimet përkatëse.

Shoqëria fillimisht zbatoi SNRF 15 më 1 janar 2018 në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNK 8 pa zbatuar ndonjë nga lehtësitë praktike. Koha ose shumta e të ardhurave nga komisionet dhe tarifet e Bankës nuk u ndikua nga zbatimi SNRF 15

### B. SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9 përcakton kërkesat për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe të disa kontratave për të blerë ose shitur zëra jo-financiare. Ky standard zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. Si rezultat i adoptimit të SNRF 9, Shoqëria ka adoptuar ndryshime rrjedhimore të SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, të cilat kërkojnë që zhvlerësimi i aktiveve financiare të paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e të fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Më parë, qasja e Shoqërisë ishte të përfshinte zhvlerësimin e kërkesave për arkëtim nga klientët në shpenzime të tjera.

Për më tepër, Shoqëria ka adoptuar ndryshime rrjedhimore të SNRF 7 Instrumentet Financiare: shpjegimet që jepen në shënimet shpjeguese për 2018 por që përgjithësisht nuk janë zbatuar në informacionin krahasues.

#### i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve financiare

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore për klasifikimin e aktiveve financiare: të matura me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDPFH"). Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 bazohet në modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e tij kontraktuale të rrjedhës së flukseve monetare. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39: të mbajtura deri në maturim, huatë dhe të arkëtueshme, të vlefshme për shitje. Sipas SNRF 9, instrumentet derivativë për të cilat aktivi bazë është një aktiv i përfshirë në objektin e standardit, nuk ndahen. Instrumenti financiar hibrid vlerësohet dhe klasifikohet si një i tërë.

SNRF 9 përgjithësisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Adoptimi i SNRF 9 nuk ka patur efekt të rëndësishëm në politikat kontabel të Shoqërisë për detyrimet financiare.

Për më tepër shpjegime mbi mënyrën se si Shoqëria klasifikon dhe mat instrumentet financiare dhe llogaritë për fitimet dhe humbjet e lidhura me to sipas SNRF 9, shih Shënimin 7(g).

Tabela e mëposhtme dhe shënimet shpjeguese përkatëse tregojnë kategoritë ekzistuese të matjes sipas SNK 39 dhe kategoritë e reja të matjes sipas SNRF 9 për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare më 1 janar 2018. Adoptimi i SNRF 9 nuk ka efekt në vlerën kontabel të aktiveve financiare në 1 janar 2018.

Shumat në Lek	Klasifikimi ekzistues sipas SNK 39	Klasifikimi i ri sipas SNRF 9	Vlera ekzistuese kontabel sipas SNK 39	Vlera e re kontabel sipas SNRF 9
<b>Aktive financiare</b>				
Te arkëtueshme nga Fondet	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e Amortizuar	81,509,299	81,509,299
Instrumenta te borxhit qeveritar	Të mbajtura deri në Maturim	Kosto e Amortizuar	20,152,000	20,152,000
Paraja dhe ekuivalentet e saj	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e Amortizuar	398,953,641	398,953,641
<b>Totali i aktiveve financiare</b>			<b>500,614,940</b>	<b>500,614,940</b>



## 6. NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

### B. SRNF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

#### ii. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të pësuar” të SNK 39 me modelin e “humbjeve të pritshme të kredisë (HPK). Modeli i ri i zhvlerësimit aplikohet për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar, aktivet kontraktuale dhe investimet në titujt e borxhit me VDATGJ por jo për investimet në instrumente të kapitalit. Sipas SNRF 9, humbjet e kredisë njihen më shpejt në kohë krahasuar me SNK 39 - shih Shënimin 7(g) (vii). Për aktivet e përfshira në modelin e zhvlerësimit sipas SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi në përgjithësi priten të rriten dhe të bëhen më të ndryshueshme. Shoqëria ka vendosur që adoptimi i kërkesave të SNRF 9 më 1 janar 2018 nuk rezulton në shtesa në zhvlerësim.

#### iii. Tranzicioni në SNRF 9

Ndryshimet në politikat kontabël që rezultojnë nga adoptimi i SNRF 9 janë zbatuar retrospektivisht, përjashtuar rastet e paraqitura më poshtë.

- Shoqëria ka vendosur të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme lidhur me kërkesat për klasifikimin dhe matjen (përfshirë zhvlerësimin). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga adoptimi i SNRF 9 do të njihen në fitimet dhe rezervat e paspërndara më 1 janar 2018. Rrjedhimisht, informacioni i paraqitur për vitin 2017 nuk pasqyron kërkesat e SNRF 9 por ato të SNK 39.

Përcaktimi i modelit të biznesit sipas të cilit është mbajtur një aktiv financiar është bazuar në faktet dhe rrethanat që kanë ekzistuar në datën e aplikimit fillestar.

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

### a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të matur me vlerën e drejtë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit përgjithësisht njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

### b) Të ardhura nga administrimi i fondeve

Të ardhurat maten në bazë të kontratës së specifikuar me klientët. Shoqëria njihet të ardhurat kur transferon kontrollin mbi një shërbim tek klienti. Përqindjet e aplikuarat për secilin nga Fondet janë përcaktuar siç vijon: Fondi Prestigj — 1.25 % (vjetor) të vlerës neto të aktivit, Fondi Vizion — 1.25 % (vjetor) të vlerës neto të aktivit, Fondi pension — 1.5 % (vjetor) të vlerës neto të aktivit, Fondi i Investimit Euro — 1.5% (vjetor) të vlerës neto të aktivit.

*Natyra dhe koha e përbushjes së detyrimeve të performancës, duke përfshirë kushtet e konsiderueshme të pagesës.*  
Të ardhurat nga administrimi i fondeve njihen në baza ditore si një përqindje e përcaktuar e vlerës neto të aktivit për secilin nga Fondet. Faturat gjenerohen në baza mujore dhe zakonisht janë të pagueshme brenda 30 ditëve.

*Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 (e zbatueshme nga 1 janari 2018)*

Të ardhurat njihen gjatë kohës kur ofrohet shërbimi. Faza e përfundimit për përcaktimin e shumës së të ardhurave për t'u njohur vlerësohet në baza ditore.

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arketueshme nga shitja e produkteve dhe shërbimeve gjatë aktivitetit normal të Shoqërisë.

*Njohja e të ardhurave sipas SNK 18 (e zbatueshme para 1 janar 2018)*

Të ardhurat përfshinin vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arketueshme nga shitja e shërbimeve gjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. Shoqëria i njihet të ardhurat kur shumën e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, është e mundshme që përfitime ekonornike nga të ardhura do të rrjedhin tek shoqëria dhe kriteret specifike janë arritur për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë.

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Shoqëria ka aplikuar për herë të parë SNRF 15 nga 1 janar 2018. Efektet e zbatimit fillestar të SNRF 15 janë trajtuar në Shënimin 5(A).

### c) Interesi

*Politika të aplikueshme nga 1 janari 2018*

*Norma efektive e interesit*

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Në përlogaritjen e normës efektive të interesit, për instrumente financiare të ndryshëm me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria vlerëson flukset monetare të ardhshme duke konsideruar gjithë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, me përjashtim të humbjeve të ardhshme që rrjedhin nga rreziku i kredisë. Për aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria llogarit normën e interesit efektiv të rregulluar të kreditit duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara që përfshijnë edhe humbjet e pritshme të kredisë. Përlogaritja e normës efektive të interesit përfshin koston e transaksioneve dhe tarifave të paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Koston e transaksionit përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

*Kosto e amortizuar dhe vlera kontabël bruto*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim dhe për aktivet financiare, rregulluar për çdo zhvlerësim nga humbjet e pritshme të kredisë (ose zhvlerësimi përpara 1 janar 2018).

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar është kostoja e amortizuar e aktivit financiar përpara zbritjes së provizionit për humbjet e pritshme të kredisë.

*Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi*

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet mbi vlerën kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është me kredit të zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit. Megjithatë, për aktivet financiare të cilat janë bërë me kredit të zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën e interesit efektiv në koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk është më me kredit të zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet në bazë bruto.

Për aktivet financiare të cilat ishin me kredit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën e interesit efektiv të kreditit të rregulluar mbi koston e amortizuar të aktivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto edhe nëse rreziku i kreditit të aktivit përmirësohet. Për informacion se kur një aktiv konsiderohet me kredit të zhvlerësuar, shih shënimin 7(g)(vii).

*Prezantimi*

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe ATGJ përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të matur me kosto historike, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit.

*Politika e aplikuar përpara 1 janar 2018*

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektive është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet të përlogaritura të ardhshme gjatë jetëgjatësisë së pritur të aktivit ose detyrimit financiar (ose, kur është e mundur, një periudhë më e shkurtër) në vlerën aktuale të aktivit ose detyrimit. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Shoqëria vlerëson flukset e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjithë termat kontraktual të instrumentave financiarë, përveç humbjeve të ardhshme. Përlogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifave të paguara ose të marra, kosto e transaksionit, dhe zbritjet ose çmimet që janë një pjesë integrale e normës së interesit. Koston e transaksionit janë kosto shtesë të cilat i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së aktivit ose detyrimit financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshin interesin të aktiveve dhe detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar e llogarit në bazën e interesit efektiv.

### d) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ndodhin.

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### e) Perfitimet e punonjësve

#### (i) Plan me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen në fitim ose humbje pasi ofrohet shërbimi përkatës dhe përfshihet në shpenzimet e personelit.

#### (ii) Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Shoqëria paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në një fond që operohet nga shteti shqiptar, që ofron përfitime pensioni, shëndetësore dhe përfitime të tjera sociale për punonjësit. Detyrimet për të tilla kontribute njihen në fitim ose humbje kur ato janë të detyrueshme dhe përfshihen në shpenzimet e personelit. Shteti shqiptar është përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor për të tilla kontribute.

- *Lejet vjetore të paguara*

Shoqëria njih si një detyrim shumë të pazbritur të kostos së përllogaritur në lidhje me lejet vjetore të cilat priten të paguhesh në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e plotësuar.

- *Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra maten në baza të paskuntuara dhe njihen si shpenzim në periudhën kur ofrohet shërbimi. Për shumën që pritet të paguhet në lidhje me shpërblimet afatshkurtra në para, regjistrohet një provizion nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe kur ky detyrim mund të matet në mënyrë të besueshme.

### f) Shpenzimi për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

#### (i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi fitimin ose humbjen e vitit, dhe çdo sistem i tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për tu paguar ose arkëtuar që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin. Ky tatim llogaritet duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose të cilat kanë hyrë në fuqi thelbësisht në datën e raportimit. Aktivet aktuale tatimore dhe detyrimet mund të kompensohen vetëm nëse kriteret e caktuara përmbushen.

#### (ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave përkatëse të përkohshme të tatimit. Nëse shumën e diferencave të përkohshme është e pamjaftueshme për të njohur një aktiv tatim të shtyrë të plotë, atëherë fitimet të ardhshme të tatueshme, të rregulluar me anulimet e diferencave ekzistuese të përkohshme, konsiderohen, bazuar në planin e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor i lidhur me to të realizohet; të tilla reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të ardhshme të tatueshme përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që fitimet të ardhshme të tatueshme mund të ekzistojnë ndaj të cilave mund të përdoret. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore të cilat priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato anulohen, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të rezultojnë nga mënyra që Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen vetëm në rast se kriteret e caktuara përmbushen.

### g) Instrumentet financiare

#### (i) Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria njih llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit. Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### g) Instrumentet financiarë (vazhdim)

#### (i) Njohja dhe matja fillestare (vazhdim)

matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

#### (ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

#### **Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018**

##### *Aktivet Financiare*

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me kosto të amortizuar. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit. Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivit i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe,
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar.

##### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Shoqëria vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit. Informacioni i vlerësuar përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimim e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë drejtimit të Bankës;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen këto rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset e mjeteve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm se si arrihen nga Banka objektivat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset e mjeteve monetare të ardhshme.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë.

##### *Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI")*

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe koston e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe koston administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shumat e papaguar në thelb paraqet shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet: Politikë e zbatueshme nga 1 janari 2018

Aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar rrjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektive. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### g) Instrumentet financiarë (vazhdim)

#### (ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

##### **Politika e zbatueshme përpara 11anar 2018**

*Aktivet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet*

Shoqëria klasifikonte aktivet financiare në të mbajtura deri në maturim dhe hua dhe llogari të arkëtueshme. Shih (h) dhe (i)

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim dhe huatë dhe llogaritë e arkëtueshme mateshin me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet*

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

#### (iii) Çregjistrimi

*Aktivet financiare*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

*Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

#### (iv) Kompensimi (netimi)

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumatat dhe ka për qellim ti shlyeje ato ne baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

#### (v) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

##### **Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018**

*Aktive financiare*

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Shoqëria vlerëson nëse flukset monetare të aktivit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset monetare janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar fillestar konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar origjinal çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset monetare të aktivit të modifikuar, të matur me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivit financiar. Në këtë rast, Shoqëria rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivit financiar dhe njih shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih 7(c)).

*Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset monetare të tyre janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara. Diferenca midis vlerës kontabël të aktivit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk njihet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogarit duke skontuar flukset monetare të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### g) Instrumentet financiarë (vazhdim)

#### (vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlera e drejtë është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare normalisht është çmimi i transaksionit – pra vlera e drejtë e shumës së paguar ose të arkëtuar. Nëse Shoqëria përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nëpërmjet një çmimi të kuotuar në një treg aktiv duke iu referuar një aktivi ose detyrimi identik, dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë ndryshimin midis vlerës së drejtë të njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në periudhat në vijim, kjo diferencë njihet si fitim ose humbje në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi është i mbështetur plotësisht nga të dhëna të vrojtueshme në treg ose kur transaksioni mbyllet.

Shoqëria njez transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

#### (vii) Zvlerësimi

#### **Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018**

Shoqëria njez një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit, përveç letrave me vlerë për për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si 'Instrumente financiare në Fazën 1'.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

#### *Matja e HPK*

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhen Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë).

HPK skontohej duke përdorur normën efektive të aktivit financiar.

Shih shënimin 21 (b).

#### *Aktivet financiare të zhvlerësuar*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtueshme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- shkelje të kontratës si dështimi ose mospagimi në afat;
- mundësinë që debitori të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në letra me vlerë është me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
- aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
- mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### g) Instrumentet financiarë (vazhdim)

#### (vii) Zhvlerësimi (vazhdim)

detyrueshme të borxhit; dhe

- mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si 'huadhënës i fundit në radhë' për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike, të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara

*Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar*

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

#### *Fshirja*

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar. Shoqëria bën një vlerësim individual në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes duke patur parasysh mundësinë e arsyeshme të rikuperimit. Shlyerjet e shumave të fshira më parë janë përfshirë në 'humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe ATGJ. Aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë akoma subjekt i veprimeve përmbartimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave të pashlyera

### **Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2018**

#### *Aktivitetet financiare jo-derivative*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria ka vlerësuar nëse ka pasur dëshmi objektive që aktivitetet financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivitetet financiare u zhvlerësuan kur dëshmitë objektive treguan se një ngjarje e humbjes kishte ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe se ngjarja e humbjes kishte një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit që mund të vlerësoheshin me besueshmëri.

### **h) Investime të mbajtura me koston e amortizuar**

#### **Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018**

Investimet përfshijnë letra me vlerë të matura me koston e amortizuar. Shiko shenimin 7 (g).

#### **Politika e zbatueshme përpara 1 janar 2018**

Investimet e mbajtura deri në maturim ishin aktive me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturim fiks që Shoqëria kishte synimin dhe aftësinë pozitive për ti mbajtur deri në maturim. Investimet e mbajtura deri në maturim janë mbajtur me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i një shume të konsiderueshme investimesh të mbajtura deri në maturim jo afër afatit të maturimit të tyre, do të kishte rezultuar në riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe të parandalonjë që Shoqëria të klasifikojë letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim për dy vitet e tanishme dhe pasardhëse.

### **i) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një risku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

### **j) Aktive afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matje*

Aktivitetet afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

#### *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitimit humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse në momentin kur ndodhin.

#### *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit humbjes me metodën lineare. Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Pajisje Zyre	20%
Pajisje Kompjuterike	25%
Automjete	20%

## 7. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### l) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët e blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivët afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimi regjistrohet në pasqyrën e fitim humbjes duke përdorur metodën lineare. Norma vjetore e amortizimit është 25%.

### m) Standarde dhe interpretime të tjera

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 janar 2018 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar Megjithatë, Shoqëria për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja dhe të amenduara që vijnë më poshtë.

#### SNRF 16 – Qiratë

SNRF 16 zëvendëson SNK 17 Qiratë dhe interpretimet e lidhura. Standardi eliminon modelin aktual të kontabilitetit me dy modele për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eliminuar dallimin mes qirasë operative dhe financiare.

Sipas SNRF 16, kontrata është ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tilla, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim qiraje. Aktivi amortizohet dhe mbi detyrimin llogaritet interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillestare dhe më pas vijjnë duke u ulur për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan këste fikse vjetore.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standardit për:

- qiratë me një afat 12 muaj ose më pak dhe që nuk përmbajnë opsion blerje; dhe
- qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

Shoqëria do fillojë aplikimin e SNRF 16 më 1 janar 2019 duke zbatuar modelin e qasjes retrospektive të modifikuar. Efekti kumulativ i zbatimit të SNRF 16 do të njihet si rregullim i balancës hapëse të fitimit të mbartur më 1 janar 2019, pa riparaqitje të informacionit krahasues.

Shoqëria planifikon të zbatojë lehtësinë praktike për trashëguar përkufizimin e qirasë në tranzicion. Pra, do të aplikojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e lidhura para 1 janar 2019 dhe të identifikua si qira në përputhje me SNK 17 dhe IFRIC 4.

Pritet që standardi i ri, në zbatimin fillestar të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare, pasi do Shoqëria duhet të njohë në pasqyrën e pozicionit financiar aktivët dhe detyrimet e lidhura me qiratë operative për të cilat Shoqëria është qiramarrës.

Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja për qiratë operative të automjeteve, magazinës, burimit të ujit dhe apartamentit. Shpenzimet e qirasë dhe natyra e tyre do të ndryshojë pasi Shoqëria do të amortizojë të drejtën e përdorimit të aktivit dhe do të njohë shpenzim interesi mbi detyrimin për qiranë.

Më parë, Shoqëria ka njohur shpenzimet e qirasë operative në baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë dhe ka njohur aktiv dhe detyrim vetëm kur ka patur diferencë kohore midis pagesave të qirasë dhe shpenzimeve të njohura.

Shoqëria ende nuk ka përfunduar një analizë të ndikimit sasior të pritit të standardit të ri. Ndikimi faktik i adoptimit të standardit të ri më 1 janar 2019 mund të ndryshojë pasi politikat e reja kontabël janë subject ndryshimi deri sa Shoqëria të paraqesë pasqyrat e para financiare që përfshijnë datën e zbatimit fillestar.

Më 31 dhjetor 2018, pagesat e ardhshme të pa-skontuara të kontratave të qirasë sipas kushteve kontraktuale janë 16 milionë Lek.

Për pagesat e ardhshme minimale të paskontuara të qirasë operative të paanulueshme më 31 dhjetor 2018, shih shënimin 22.

Kontabiliteti për qiradhënësin do të mbetet kryesisht i pandryshuar dhe do të ruhet dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare.

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19);
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 – disa standarde;
- Ndryshimet në referencat e Kornizës Konceptuale të Standarteve SNRF

Përkufizimi i materialitetit – (Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 8)



## 8. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga llogari rrjedhëse të mbajtura në Bank vendase dhe të detajuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Llogari në Bank	42,247,116	18,953,641
Depozita në lek me maturim me pak se 3 muaj	330,000,000	380,000,000
<b>Total</b>	<b>372,247,116</b>	<b>398,953,641</b>

Në datë 31 dhjetor 2018 dhe 2017 depozitat janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Data e vendosjes	4 dhjetor 2018	7 dhjetor 2017
Data e maturimit	4 janar 2019	5 janar 2018
Norma e interesit	0.1%	0.1%

## 9. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA FONDET

Shumat e arkëtueshme nga fondet i përkasin komisioneve të administrimit për muajin dhjetor të pagueshme nga secili prej Fondeve në Administrimin e Shoqërisë, si dhe penaliteteve për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar (të tjera) dhe janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Te arkëtueshme nga fondi i Investimit Prestigj	51,026,163	60,963,932
Te arkëtueshme nga fondi i Investimit EURO	13,499,385	18,754,659
Te arkëtueshme nga fondi i Investimit Vizion	5,749,293	-
Te arkëtueshme nga fondi i Pensionit	786,714	639,284
Penalite për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar	1,619,496	1,151,424
<b>Total</b>	<b>72,681,051</b>	<b>81,509,299</b>

## 10. INVESTIME ME KOSTO TË AMORTIZUAR

Shumat e arkëtueshme nga fondet i përkasin komisioneve të administrimit për muajin dhjetor të pagueshme nga secili prej Fondeve në Administrimin e Shoqërisë, si dhe penaliteteve për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar (të tjera) dhe janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Vlera nominale	5,000,000	20,000,000
Interest i përlogaritur	102,500	152,000
<b>Total</b>	<b>5,102,500</b>	<b>20,152,000</b>

Investimet përbëhen nga bonde 7-vjecare të nominuar në Lek të emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me normë kuponit 7,38%. Kuponi paguhet cdo 6-muaj.

	Vlera nominale	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	5,000,000	102,500	5,102,500
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>5,000,000</b>	<b>102,500</b>	<b>5,102,500</b>

## 10. INVESTIME ME KOSTO TË AMORTIZUAR (VAZHDIM)

	Vlera nominale	Interesa të përlogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	20,000,000	152,000	20,152,000
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>20,000,000</b>	<b>152,000</b>	<b>20,152,000</b>

Lëvizjet në vlerat nominale të aktiveve të mbajtura deri në maturim paraqiten si me poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Më 1 janar	20,000,000	20,000,000
Të maturuara gjatë vitit	(15,000,000)	-
<b>Total</b>	<b>5,000,000</b>	<b>20,000,000</b>

## 11. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Automjete	Pajisje zyre dhe informatike	Totali
<b>Kosto</b>			
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	<b>16,941,869</b>	<b>13,963,204</b>	<b>30,905,073</b>
Shtesa	2,504,583	72,560	<b>2,577,143</b>
Pakësime	(7,404,359)	-	<b>(7,404,359)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>12,042,093</b>	<b>14,035,764</b>	<b>26,077,857</b>
Shtesa	-	1,012,562	<b>1,012,562</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>12,042,093</b>	<b>15,048,326</b>	<b>27,090,419</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>			
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	<b>5,919,588</b>	<b>7,096,783</b>	<b>13,016,371</b>
Shpenzimi i vitit	1,819,444	1,674,848	<b>3,494,292</b>
Pakësime	(2,429,065)	-	<b>(2,429,065)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>5,309,967</b>	<b>8,771,631</b>	<b>14,081,598</b>
Shpenzimi i viti	1,346,304	1,315,278	<b>2,661,582</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>6,656,271</b>	<b>10,086,909</b>	<b>16,743,180</b>
<b>Vlera kontabël</b>			
<b>Më 1 Janar 2017</b>	<b>11,022,281</b>	<b>6,866,421</b>	<b>17,888,702</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>6,732,126</b>	<b>5,264,133</b>	<b>11,996,259</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>5,385,822</b>	<b>4,961,417</b>	<b>10,347,239</b>

## 12. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

	Programe Kompjuterike	Totali
<b>Kosto</b>		
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	<b>22,839,170</b>	<b>22,839,170</b>
Shtesa	162,042	<b>162,042</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>23,001,212</b>	<b>23,001,212</b>
Shtesa	2,664,719	<b>2,664,719</b>
Pakësime	(162,042)	<b>(162,042)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>25,503,889</b>	<b>25,503,889</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>		
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	<b>14,355,971</b>	<b>14,355,971</b>
Shpenzimi i vitit	2,267,612	<b>2,267,612</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>16,623,583</b>	<b>16,623,583</b>
Shpenzimi i vitit	1,764,186	<b>1,764,186</b>
Pakësime	(162,042)	<b>(162,042)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>18,225,727</b>	<b>18,225,727</b>
<b>Vlera kontabël</b>		
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>8,483,199</b>	<b>8,483,199</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,377,629</b>	<b>6,377,629</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>7,278,162</b>	<b>7,278,162</b>

## 13. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera dhe provigjonet për detyrime dhe pagesa përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Detyrime ndaj Bankës Kujdestare	4,835,004	5,230,134
Detyrime ndaj Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	2,808,860	3,063,839
Shpenzime të përlogaritura auditimi	851,832	1,703,194
Detyrime për sigurimet shoqërore	433,768	430,317
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	405,357	394,642
Furnitorë	2,296,120	528,900
Shpërblim i përlogaritur për punonjësit	3,649,325	3,700,904
Të tjera	1,027,180	910,143
<b>Totali</b>	<b>16,307,446</b>	<b>15,962,073</b>

## 14. KAPITALI AKSIONAR

Me 31 dhjetor 2018 dhe 2017, kapitali aksionar i rregjistruar është 90,000,000 Lek i përbërë nga 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000.08 Lek secili. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a. dhe aksioneri përfundimtar është Raiffeisen Bank International AG.

## 15. REZERVA LIGJORE

Bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë e tregtare" si dhe statutin e Shoqërisë, Shoqëria mban një rezervë ligjore dhe transferon çdo vit 5% të fitimit neto të realizuar në vitin financiar paraardhës derisa shuma të arrijë 10% të vlerës së kapitalit, Duke qënë se rezerva ligjore e ka arritur nivelin 10% të vlerës së kapitalit, nuk ka patur ndryshim në rezervën ligjore gjatë vitit 2018.

Përdorimi i këtyre rezervave ligjore është në vullnetin e aksionereve.

## 16. TARIFA TË ADMINISTRIMIT TË FONDEVE

	2018	2017
Raiffeisen Prestigj	652,147,500	708,565,742
Raiffeisen Invest Euro	187,967,804	214,404,428
Raiffeisen Vizion	15,623,853	-
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	8,453,618	6,842,353
<b>Totali</b>	<b>864,192,775</b>	<b>929,812,523</b>

Të ardhurat e administrimit të Fondëve llogariten mbi Vlerën Neto të Aktiveve ditore për secilin fond, bazuar në tarifën e përcaktuar, të detajuar si më poshtë:

- Fondi Pretigj – 1.25% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve;
- Fondi Vizion – 1.25% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve;
- Fondi Pensionit – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve;
- Fondi Raiffeisen Invest Euro – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve,

Shpenzimi llogaritet në bazë ditore.

## 17. TË ARDHURA NGA INTERESAT LLOGARITUR ME METODËN E INTERESIT EFEKTIV

Të ardhurat nga interesi i instrumentave financiare sipas kategorive përbëhen si më poshtë:

	2018	2017
Obligacione të qeverisë	1,309,500	1,359,000
Depozita dhe llogari rrjedhëse	256,164	272,863
	<b>1,565,664</b>	<b>1,631,863</b>

## 18. SHPENZIME PERSONELI

Kosto e personelit përbëhet nga si më poshtë:

	2018	2017
Paga, shpërblime	39,268,687	37,665,072
Sigurime shoqërore	3,060,741	2,927,896
Kosto të tjera të personelit	1,445,713	1,545,434
<b>Totali</b>	<b>43,775,141</b>	<b>42,138,402</b>

## 19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme administrative përbëhen nga si më poshtë:

	2018	2017
Tarifa të tjera të administrimit të fondeve	314,971,550	340,533,200
Marketing dhe sponsorizime	110,563,835	89,504,146
Shpenzime lidhur me Bankën Depozitare	58,211,763	60,897,089
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	25,773,724	25,149,371
Shpenzime të shitjes	15,255,300	16,081,500
Komisione	13,958,476	7,017,459
Shpenzime mirëmbajtje	9,641,159	10,163,981
Qira	4,134,289	4,355,900
Taksa dhe TVSH	2,502,383	3,422,481
Udhëtime dhe dieta	487,289	2,297,405
Shpenzime të tjera personeli	340,080	2,312,340
Shpenzime telefonike dhe internet	245,062	366,871
Siguracion	207,609	270,425
Noter dhe shpenzime ligjore	8,600	25,220
Të tjera	6,288,900	6,442,780
<b>Totali</b>	<b>562,590,019</b>	<b>568,840,168</b>

Tarifat e tjera të administrimit të fondeve lidhen me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Raiffeisen Bank sh.a dhe Raiffeisen Invest sh.a datë 03 janar 2013 në bazë të së cilës Raiffeisen Invest sh.a angazhohet të pajisë të gjithë investitorët me një paketë shërbimesh Shoqëriare të ofruara nga Raiffeisen Bank sh.a dhe të mbulojë nëpërmjet pagesave mujore të gjitha kostot e shërbimeve të përfshira në paketë. Për vitin 2018 kostoja e shërbimeve të paketës është 950 Lek/për investitor. (2017: 950 Lek/për investitor)

Bazuar në rregulloren nr. 18/1, datë 15 shkurt 2010 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (të rishikuar në 6 tetor 2011), shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve dhe të investimeve duhet të paguajnë kundrejt Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një tarifë vjetore prej 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve). (2017: 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të muajit për fondet e investimeve dhe 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të tremujorit për fondet e pensioneve).

## 20. TATIM MBI FITIMIN

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në 2018, norma e tatimit në Shqipëri është e barabartë me 15% (2017: 15%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përlogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	Norma efektive tatimit	31 Dhjetor 2018	Efektive	31 Dhjetor 2017
Fitimi përpara tatimit		255,583,409		316,632,540
Tatimi në normën e aplikueshme	15%	(38,337,511)	15%	(47,494,880)
Shpenzime të pazbritshme	24.9%	(63,674,824)	20.5%	(64,861,899)
<b>Tatim fitimi</b>	<b>39.9%</b>	<b>(102,012,335)</b>	<b>35.5%</b>	<b>(112,356,779)</b>

Në efektin tatimor të shpenzimeve të pazbritshme është përfshirë një shumë prej Lek 49,534,028 (2017: Lek 51,079,980) që lidhet me shpenzimet për shërbimet e marra nga Raiffeisen Bank sh.a.

## 20. TATIM MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Tatim fitimi i Shoqërisë rivlerësohet nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatim fitimit që përcaktohen nga menaxhimi si më të mundshmet që të mos rezultojë në tatime shtesë, nëse pozicioni tatimor do të kontestohet nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore në fuqi ose që konsideroheshin në fuqi në fund të periudhës raportuese dhe në çdo gjykim ose rregullore tjetër për të tilla çështje. Detyrimet për gjoba, interesa dhe tatime të tjera nga tatim fitimi njihen duke u bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit për shpenzimin e nevojshëm për të mbyllur detyrimin në fund të periudhës raportuese.

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Efkti i zbatimit të SNRF 9 për instrumentet financiare është përshkruar në shënimin 5. Për shkak të metodës së ndryshimit të zgjedhur, informacioni krahasues për të reflektuar kërkesat e reja nuk është riparaqitur.

### a) Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka dhënë informacione shpjeguese për vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare jo të matura me vlerë të drejtë, sepse vlera e tyre e mbetur është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

*Paraja dhe ekuivalentë e saj*

Paraja dhe ekuivalentë e saj përfshijnë llogari rrjedhëse në bankat vendase. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë është konsideruar e barabartë me vlerën e tyre të mbetur.

*Asetet financiare me kosto amortizuar*

Asetet financiare me kosto amortizuar përfshijnë obligacione qeveritare të qeverisë shqiptare. Vlera e drejtë për këto investime është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të skontuara bazuar në një kurbë të yield-it aktual të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim. Vlera e drejtë përafron koston e amortizuar për shkak të interesit të ulët dhe maturimit afatshkurtër.

### b) Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë.

#### **Struktura e Administrimit të rrezikut**

Bordi i Administrimit ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Kompanisë. Bordi është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqërisë, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

#### **(i) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual i rrezikut dhe rreziku i sektorit). Bordi i Administrimit të Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë në

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

bono thesaru dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paraja dhe ekuivalentët e sa	372,247,116	398,953,641
Të arkëtueshme nga Fondet	72,681,051	81,509,299
Aktive financiare te matura me kosto të amortizuar	5,102,500	20,152,000
<b>Totali</b>	<b>450,030,667</b>	<b>500,614,940</b>

#### **Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	2018	2017
Vendase	450,030,667	500,614,940
<b>Totali</b>	<b>450,030,667</b>	<b>500,614,940</b>

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	2018	2017
					Totali	Totali
Qeveria e Republikës së Shqipërisë B+	5,102,500	-	-	-	5,102,500	20,152,000
Paraja dhe ekuivalentët e saj, te pa rankuara	372,247,116	-	-	-	372,247,116	398,953,641
Humbja nga zhvlerësimi	-	-	-	-	-	-
<b>Vlera kontabël</b>	<b>377,349,616</b>	-	-	-	<b>377,349,616</b>	<b>419,105,641</b>

#### *Investimet e letrave me vlerë*

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në monedhën vendase në afatin e shkurtër.

Qeveria shqiptare është vlerësuar si B +, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e Standard & Poor's dhe B1, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e Moody's.

#### *Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria zbaton një model 12-mujor të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e parasë dhe ekuivalentëve të saj.

Në aplikimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Shoqëria nuk ka njohur humbje zhvlerësimi më 1 janar 2018 dhe gjatë 2018.

#### *Të arkëtueshme nga Fondet*

Normat e humbjeve bazohen në përvojën aktuale të humbjes së kredisë gjatë pesë viteve të fundit. Këto norma rregullohen me faktorë skalarë për të pasqyruar ndryshimet midis kushteve ekonomike gjatë periudhës mbi të cilën janë grumbulluar të dhënat historike, kushtet aktuale dhe pikëpamjen e Shoqërisë për kushtet ekonomike gjatë jetës së pritshme të të arkëtueshmeve.

Faktorët rregullues bazohen në pagat mesatare bruto aktuale dhe të parashikuara për Shqipërinë (2.01%).

Në tabelën e mëposhtme jepen informacione për ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë dhe HPK më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Në Lek	Mesatarja e ponderuar e raportit të humbjes	Vlera kontabël bruto	Humbja nga zhvlerësimi	Zhvlerësim i kredise
<b>31 dhjetor 18</b>				
Pa vonesa	0%	72,681,051	-	Jo
		<b>72,681,051</b>	<b>-</b>	
<b>31 dhjetor 17</b>				
Pa vonesa	0%	81,509,299	-	Jo
		<b>81,509,299</b>	<b>-</b>	

### Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përllogaritjen e zhvlerësimit

Shiko politikën kontabël në shënimin 7(g)(vii).

#### Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Shoqëria konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Shoqërisë.

Shoqëria monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë.

#### Përkufizimi i deshtimit

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qenë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë.
- Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:
- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe
- bazuar në të dhënat e zhvilluara së brendshmi dhe të marra nga burime të jashtme.

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana

#### Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(g)(v).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

- PD-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me
- PD-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

### Matje e HPK

#### Të arkëtueshme nga Fondet

Shoqëria përdor matricën e zbritjeve për të matur HPK nga kërkesat për arkëtim nga fondet. Normat e humbjeve llogariten duke përdorur metodën e 'normave të transferimit' bazuar në probabilitetin e të arkëtueshmes që kalon fazat e njëpasnjëshme të mundësisë për të mos u shlyer. Normat e kalimit llogariten veçmas për ekspozime në segmente të



## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

ndryshme bazuar në karakteristikat e mëposhtme të përbashkëta të rrezikut të kredisë.

#### *Paraaja dhe ekuivalentët e saj*

Paraaja dhe ekuivalentët e saj mbahet me Bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbjeje 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit. Në zbatimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Shoqëria nuk ka njohur një humbje nga zhvlerësimi më 1 janar 2018 dhe gjatë vitit 2018.

#### *Investimet e letrave me vlerë*

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm:

- probabiliteti i dështimit (PD);
- humbja nga dështimi (HND);
- ekspozimi në rast dështimi (END).

Vlerësimet e PD janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiorë dhe cilësorë.

HND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një default dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit.

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një default. Shoqëria nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. END i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e END janë llogaritur në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës.

Shoqëria mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk kishte aktive financiare me kredit të zhvlerësuar.

### **(ii) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare.

#### ***Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit***

Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa të jetë e mundur, që gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij kur është e nevojshme, në kushte normale dhe të rënda, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë. Tabela në vijim tregon flukset e mjeteve monetare të skontuara në aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë në bazë të maturimit të tyre të hershëm të mundshëm kontraktual ose rrjedhjes së parave të gatshme, pasi efekti i zbritjes nuk konsiderohet material.

31 dhjetor 2018						
Aktivët	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	372,247,116	-	-	-	-	372,247,116
Të arketueshme nga Fondet	72,681,051	-	-	-	-	72,681,051
Letra me vlerë	-	-	-	-	5,102,500	5,102,500
<b>Totali</b>	<b>444,928,167</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,102,500</b>	<b>450,030,667</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	7,982,956	-	-	-	-	7,982,956
<b>Totali</b>	<b>7,982,956</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>7,982,956</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>436,945,211</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,102,500</b>	<b>442,047,711</b>
<b>Kumulative</b>	<b>436,945,211</b>	<b>436,945,211</b>	<b>436,945,211</b>	<b>436,945,211</b>	<b>442,047,711</b>	
31 dhjetor 2017						
Aktivët	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	398,953,641	-	-	-	-	398,953,641
Të arketueshme nga Fondet	81,509,300	-	-	-	-	81,509,300
Letra me vlerë	-	-	-	15,049,500	5,102,500	20,152,000
<b>Totali</b>	<b>480,462,941</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>15,049,500</b>	<b>5,102,500</b>	<b>500,614,941</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	7,462,228	-	-	-	-	7,462,228
<b>Totali</b>	<b>7,462,228</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>7,462,228</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>473,000,713</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>15,049,500</b>	<b>5,102,500</b>	<b>493,152,713</b>
<b>Kumulative</b>	<b>473,000,713</b>	<b>473,000,713</b>	<b>473,000,713</b>	<b>488,050,213</b>	<b>493,152,713</b>	

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (iii) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si norma e interesit, kurset e këmbimit valutor dhe përhapjet e kredisë do të ndikojnë në të ardhurat e kompanisë ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit*

Rreziku kryesor për të cilin janë ekspozuar portofolet tregtare është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e ardhshme të mjeteve monetare ose vlerat e drejta të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlerat aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht përmes monitorimit të mangësive të normave të interesit. Aktivet financiare që mbartin interesa më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë paraqitur më poshtë:

Fixed-rate financial assets	2018	2017
Investment securities	5,102,500	20,152,000
Deposit	330,000,000	380,000,000
<b>Total</b>	<b>335,102,500</b>	<b>400,152,000</b>

#### *Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse*

Shoqëria nuk mban aktive dhe detyrimet financiare me normë fikse me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Prandaj, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në fitimin ose humbjen. Një ndryshim prej 100 pikësh bazë në normat e interesit nuk do të kishte rritur ose ulur kapitalin.

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të monedhës pasi transaksionet në monedhat e huaja nuk janë të shpeshta. Rreziku i valutës menaxhohet përmes përdorimit të përputhjes së aktiveve dhe detyrimeve. Normat e aplikueshme zyrtare të Shoqërisë (Lek ndaj njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018		31 Dhjetor 2017	
	Në fund periudhe	Mesatar	Në fund periudhe	Mesatar
Dollari Amerikan (USD)	107.82	108.01	110.10	119.05
Monedha e Bashkimit European (EUR)	123.42	127.58	132.95	134.13

#### (iv) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga një shumëllojshmëri e shkaqeve të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kreditit, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullative dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik. Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Bordit të Administrimit. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- Segregimi i duhur i detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve
- pajtimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ligjore
- dokumentimin e kontrolleve dhe procedurave
- Vlerësimi periodik i rreziqeve operacionale, përshtatshmëria e kontrolleve dhe procedurave
- Raportimi i humbjeve operacionale dhe veprimi i propozuar riparues

## 21. INSTRUMENTET FINANCIARE – VLERA E DREJTË DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

### b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

- Zhvillimi i planeve të emergjencës
- Trajnimi dhe zhvillimi profesional, standardet etike dhe të biznesit
- zbutjen e riskut, duke përfshirë sigurimin aty ku kjo është efektive.

## 22. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTEZUARA

jentëve për instrumentat financiarë të tregtuara në tregjet aktive. Për gjithë instrumentat e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Këto teknika përfshijnë teknikat e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të zbritshme, krahasimin me instrumentat e ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të verifikueshme, dhe modele vlerësimi

### Pagesat e ardhshme minimale të qirasë

Më 31 dhjetor, pagesat minimale të qirasë në të ardhmen sipas qirasave të pa-anullueshme ishin të pagueshme si më poshtë.

	2018	2017
Më pak se një vit	1,001,998	1,079,368
Nga 1 deri në 5 vite	-	-
Më shumë se 5 vite	-	-
	<b>1,001,998</b>	<b>1,079,368</b>

## 23. PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka një marrëdhënie palësh të lidhura me shoqërinë mëmë, Raiffeisen Bank sh.a. Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, Shoqëria ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura:

### Ndaj Raiffeisen Bank sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paraja dhe ekuivalentët e sa (Shënimi 8)	367,296,162	396,155,922
<b>Totali</b>	<b>367,296,162</b>	<b>396,155,922</b>
<b>Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		
<b>Të ardhura</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Transaksione shpenzimesh	133,132	176,935
<b>Totali</b>	<b>133,132</b>	<b>176,935</b>
<b>Shpenzime (Shënimi 19)</b>		
Tarifa të tjera të administrimit të fondeve	314,971,550	340,533,200
Shpenzime të shitjes	15,255,300	16,081,500
<b>Total</b>	<b>330,226,850</b>	<b>356,614,700</b>
Dividend i shpërndarë dhe i paguar	190,670,626	-

## 23. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

### Ndaj Fondeve

<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Të arkëtueshme nga Fondet (Shënimi 9)	72,681,051	81,509,299
<b>Totali</b>	<b>72,681,051</b>	<b>81,509,299</b>
<b>Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		
<b>Të ardhura (Shënimi 16)</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Te ardhura nga administrimi i fondeve	864,192,775	929,812,523
<b>Totali</b>	<b>864,192,775</b>	<b>929,812,523</b>
Kompensimi për drejtimin kyc	17,963,166	15,752,941
<b>Totali</b>	<b>17,963,166</b>	<b>15,752,941</b>

## 24. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

**Kompania e Administrimit** pergatit Raporte te plota Financiare per Fondet nen Menaxhim te permendura me poshte:

- **Fondi Raiffeisen Prestigj**
- **Fondi Raiffeisen EURO**
- **Fondi Raiffeisen Vizion**
- **Fondi Raiffeisen Pension**

Keto raporte jane te audituara dhe mund te gjenden ne link <https://www.raiffeisen-invest.al/en/raportet-financiare>. Ne seksionin ne vazhdim jane vendosur pasqyrat kryesore financiare per secilin nga fondet.

# RAIFFEISEN PRESTIGJ

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	10	2,422,253	1,258,163
Të ardhura nga interesi nga instrumenta të mbajtura me VDNPF		-	1,354,904
Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes		-	(1,283,202)
Të ardhura të tjera		-	78
		<b>2,422,253</b>	<b>1,329,943</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit		(652,147)	(708,566)
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiare	8 c)	(20,755)	-
		<b>(672,902)</b>	<b>(708,566)</b>
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>1,749,351</b>	<b>621,377</b>
<b>Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		376,779	1,514,936
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave të fondit</b>		<b>2,126,130</b>	<b>2,136,313</b>

# RAIFFEISEN PRESTIGJ

Pasqyra e pozicionit financiar  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Aktivët</b>			
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	11	-	30,025,849
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse	12	43,170,012	21,033,231
Paraja dhe ekuivalentë të saj	13	5,852,811	6,200,104
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>49,022,823</b>	<b>57,259,184</b>
<b>Detyrimet</b>			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit		51,026	60,964
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi		122,467	88,351
Detyrime të tjera	14	34,189	21,628
Detyrime nga blerja e instrumentave të borxhit		1,191,079	-
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>1,398,761</b>	<b>170,943</b>
<b>AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE</b>	15	<b>47,624,062</b>	<b>57,088,241</b>
Numri i mijë kuotave të ofruara nga Fondi		31,841	39,786
<b>AKTIVET NETO PËR KUOTË NË LEK</b>		<b>1,496</b>	<b>1,435</b>

## RAIFFEISEN PRESTIGJ

Pasqyra e ndryshimeve në kapital per aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Aktive neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave më 1 Janar</b>		<b>57,088,241</b>	<b>51,667,310</b>
Kontribute		3,527,941	14,160,057
Terheqje nga mbajtësit e kuotave		(15,118,250)	(10,875,439)
		<b>(11,590,309)</b>	<b>3,284,618</b>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësit e kuotave		1,749,351	621,377
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		376,779	1,514,936
<b>Rritja neto</b>		<b>2,126,130</b>	<b>2,136,313</b>
<b>Aktivitet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>15</b>	<b>47,624,062</b>	<b>57,088,241</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË</b>			
Të ofruara/emetuara bazuar në kontribute		2,426	10,063
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(10,371)	(7,678)
<b>(ZVOGELIM)/RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT</b>		<b>(7,945)</b>	<b>2,385</b>



# RAIFFEISEN PRESTIGJ

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Flukse monetare nga aktiviteti operativ</b>			
<b>Të ardhura neto</b>		<b>1,749,351</b>	<b>621,377</b>
<b>Rregullime për:</b>			
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes		-	1,283,202
Të ardhura nga interesi		(2,422,253)	(2,613,067)
Humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare.	8 c)	20,755	-
		<b>(652,147)</b>	<b>(708,488)</b>
<b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative</b>			
Aktive financiare të mbajtura me VDNFH		-	(4,449,362)
Aktive financiare të mbajtura me VDNAGJP		8,238,900	(6,004,278)
Aktive financiare të mbajtura me koston e amortizuar		-	6,032,683
Detyrime nga blerja e instrumentave të borxhit		1,191,079	-
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit		(9,938)	5,572
Detyrime të tjera		12,561	(26,407)
		<b>8,780,455</b>	<b>(5,150,280)</b>
Interes i arkëtuar		2,428,445	2,568,058
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ</b>		<b>11,208,900</b>	<b>(2,582,222)</b>
<b>Flukse monetare nga aktiviteti financues</b>			
Kontribute nga mbajtësit e kuotave		3,527,941	14,160,056
Kontribute të paguara te mbajtësit e kuotave		(15,084,134)	(10,839,353)
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti financues</b>		<b>(11,556,193)</b>	<b>3,320,703</b>
<b>Zvogelimi neto në para dhe ekuivalentet e saj</b>		<b>(347,293)</b>	<b>738,481</b>
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit	13	6,200,104	5,461,623
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit		5,852,811	6,200,104

## FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura neto nga interesat	10	299,678	375,332
Ndryshime në vlerën e drejtë të instrumentave financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	11	(348,193)	174,863
Të ardhura të tjera operative		39,697	44,858
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>(8,818)</b>	<b>595,053</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë administruese		(188,268)	(214,407)
Shpenzime të tjera operationale		(466)	210
Humbje neto nga kursi i këmbimit	12	(247,480)	(151,558)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(436,214)</b>	<b>(365,755)</b>
<b>(Zvogelimi)/Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>		<b>(445,032)</b>	<b>229,298</b>

# FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO

Pasqyra e pozicionit financiar  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Aktivët</b>			
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	13	6,790,952	10,387,789
Kuota ne fonde investimi me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	14	2,686,218	3,618,106
Paraja dhe ekuivalentë të saj	15	907,616	738,862
Llogari të arkëtueshme të tjera		407	623
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>10,385,193</b>	<b>14,745,380</b>
<b>Detyrimet</b>			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë administruese		13,499	18,755
Të pagueshme për tërheqjet e mbajtësve te kuotave		59,963	11,746
Detyrime të tjera	16	2,647	1,437
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>76,109</b>	<b>31,938</b>
<b>AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE</b>	17	<b>10,309,084</b>	<b>14,713,442</b>
Numri në mijë kuota të emtuara nga fondi euro		726,131	946,389
<b>AKTIVET NETO PËR KUOTË NË LEK</b>		<b>14,197</b>	<b>15,547</b>

## FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar</b>		<b>14,713,442</b>	<b>13,606,435</b>
Kontribute		834,826	3,516,703
Tërheqjet		(4,078,618)	(2,553,624)
Efekti i përkthimit		(715,534)	(85,370)
		<b>(10,754,116)</b>	<b>14,484,145</b>
(Zvogëlim)/Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave nga aktiviteti		(445,032)	229,298
<b>Aktive neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>	<b>17</b>	<b>10,309,084</b>	<b>14,713,442</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË</b>			
Të ofruara/emetuara bazuar në kontribute		55,704	227,514
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(275,962)	(164,968)
<b>(ZVOGËLIM)/RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT</b>		<b>(220,258)</b>	<b>62,546</b>

# FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Flukse monetare nga aktiviteti operacional</b>			
<b>(Ulja)/Rritja në aktivet neto që i atribuohet kontribuuesve</b>		<b>(445,033)</b>	<b>229,298</b>
<b>Rregullime për:</b>			
Humbe/(Fitime) të porealizuara nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	11	201,411	(201,627)
Efekti i përkthimit		(715,534)	(85,370)
Të ardhura nga interesi		(299,678)	(375,332)
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ</b>		<b>(1,258,833)</b>	<b>(433,031)</b>
<b>Ndryshimet në:</b>			
Instrumentat financiare me VDNFH		3,357,891	(1,527,230)
Kuota në fonde investimi		931,888	(1,445,148)
Të pagueshme ndaj shoqërisë administruese		(5,256)	1,493
Llogari të tjera të arkëtueshme		216	(382)
Detyrime të tjera		1,210	(1,001)
		<b>3,027,116</b>	<b>(3,405,299)</b>
Interes i arkëtuar		337,213	367,637
<b>Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale</b>		<b>3,364,329</b>	<b>(3,037,662)</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti financues</b>			
Kontribute të arketuara nga mbajtësit e kuotave		834,826	3,516,703
Kontribute të paguara ndaj mbajtësve të kuotave		(4,030,401)	(2,550,738)
<b>Flukset monetare neto nga aktiviteti financues</b>		<b>(3,195,575)</b>	<b>965,965</b>
<b>Rritje neto në flukset e parasë</b>			
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit		738,862	2,810,559
<b>Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit</b>	<b>17</b>	<b>907,616</b>	<b>738,862</b>

# RAIFFEISEN VIZION

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	Për periudhën nga 20 gusht 2018 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2018
<b>Të ardhura</b>		
Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	9	42,087
Të ardhura të tjera		339
		<b>42,426</b>
<b>Shpenzime</b>		
Tarifa e fondit të Administrimit		(15,624)
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiare	7c)	(2,120)
		<b>(17,744)</b>
<b>Totali i të ardhurave neto</b>		<b>24,682</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse</b>		
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse	10	54,590
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave</b>		<b>79,272</b>

# RAIFFEISEN VIZION

Pasqyra e pozicionit financiar  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018
<b>Aktivët</b>		
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	11	4,410,069
Të arkëtueshme nga kuotat e emetuara	14	69,108
Paraja dhe ekuivalentë të saj	12	1,941,669
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>6,420,846</b>
<b>Detyrimet</b>		
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		5,749
Detyrime të tjera	13	296,121
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>301,870</b>
<b>AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE</b>	<b>15</b>	<b>6,118,976</b>
Numri i mijë kuotave të emetuara të Fondit Vizion		6,012
<b>AKTIVET NETO PËR KUOTË NË LEK</b>		<b>1,018</b>

## RAIFFEISEN VIZION

Pasqyra e ndryshimeve te aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të njësive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018
<b>Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 20 gusht (data e krijimit)</b>		-
Kontribute kapitale		6,056,665
Tërheqje për pagesat e përfitimeve		(16,961)
		<b>6,039,704</b>
Rritje në aktive neto të atribueshme ndaj kontribuesve		24,682
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		54,590
Rritje neto		79,272
<b>Aktive neto të atribueshme ndaj kontribuesve</b>	<b>15</b>	<b>6,118,976</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË</b>		
Të ofruara/emetuara bazuar në kontribute		6,029
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(17)
<b>RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT</b>		<b>6,012</b>



# RAIFFEISEN VIZION

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

Shënime	Për periudhën nga 20 gusht 2018 (data e krijimit) deri më 31 dhjetor 2018
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti operativ</b>	
<b>Të ardhura neto</b>	<b>24,682</b>
<b>Rregullime për:</b>	
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë	2,120
Të ardhura nga interesat	(42,087)
	<b>(15,285)</b>
<b>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</b>	
Aktive financiare të matura me VDATGj	(4,354,903)
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	5,749
Detyrime të tjera	296,121
	<b>(4,068,318)</b>
Interesi i marrë	39,391
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ</b>	<b>(4,028,927)</b>
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti financues:</b>	
Kontribute të arkëtuara nga mbajtësit e kuotave	5,987,557
Kontribute të paguara mbajtësve të kuotave	(16,961)
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti financues</b>	<b>5,970,596</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to</b>	<b>1,941,669</b>
Paraja dhe ekuivalentë të saj në 20 gusht	-
<b>Paraja dhe ekuivalentë të saj në datën e raportimit</b>	<b>1,941,669</b>

# FFONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura nga interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv	10	38,880,543	29,411,336
Të ardhura nga interesi nga instrumentat financiarë të aktiveve financiare me VDPFH	11	-	3,467,044
Ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		-	(162,364)
		<b>38,880,543</b>	<b>32,716,016</b>
<b>Shpenzime</b>			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit		(8,453,618)	(6,842,354)
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë		(266,716)	-
		<b>(8,720,334)</b>	<b>(6,842,354)</b>
<b>Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>30,160,209</b>	<b>25,873,662</b>
Ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		(87,381)	-
<b>Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave të pensionit nga operacionet</b>		<b>30,072,828</b>	<b>25,873,662</b>

# FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

Pasqyra e pozicionit financiar  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Aktivët</b>			
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet te ardhurave gjithëpërfshirëse	12	61,163,438	-
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	11	-	48,893,635
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	13	555,784,693	451,218,018
Paraja dhe ekuivalentë të saj	14	8,918,222	9,078,383
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>625,866,353</b>	<b>509,190,036</b>
<b>Detyrimet</b>			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit		786,714	639,285
Të pagueshme për kërkesa tërheqje nga fondi		399,470	173,574
Detyrime të tjera	15	1,817,807	1,401,909
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>3,003,991</b>	<b>2,214,768</b>
<b>AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT</b>	<b>16</b>	<b>622,862,362</b>	<b>506,975,270</b>
Numri i mijë kuotave të emetuara të Fondit të Pensionit		361,200	310,083
<b>AKTIVET NETO PËR NJËSI</b>		<b>1,724</b>	<b>1,635</b>

## FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

Pasqyra e ndryshimeve në kapital per aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të njërive më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
<b>Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar</b>		<b>506,975,270</b>	<b>412,207,866</b>
Kontribute kapitale		106,132,292	86,093,539
Tërheqje për pagesat e përfitimeve të pensionit dhe tërheqje të parakohshme		(20,318,028)	(17,199,797)
		<b>85,814,264</b>	<b>68,893,742</b>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kontribuesve		30,160,209	25,873,662
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		(87,381)	-
<b>Rritja neto</b>		<b>30,072,828</b>	<b>25,873,662</b>
<b>Aktive neto të atribueshme ndaj kontribuesve</b>	<b>16</b>	<b>622,862,362</b>	<b>506,975,270</b>
<b>NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT NË MIJË</b>			
Të ofruara/emetuara bazuar në kontribute		63,298	53,986
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(12,181)	(10,800)
<b>RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT</b>		<b>51,117</b>	<b>43,186</b>

# FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
(shumat në mijë Lek)

	Shënime	2018	2017
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti operacional</b>			
<b>Të ardhurat neto</b>		<b>30,160,209</b>	<b>25,873,662</b>
<b>Rregullime për:</b>			
Ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		-	162,364
Humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë	8 c)	266,716	-
Të ardhura nga interesi		(38,880,543)	(29,411,336)
		<b>(8,453,618)</b>	<b>(6,842,354)</b>
<b>Ndryshime:</b>			
Aktivet financiare të matura me VDPFH		-	7,581,828
Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar		(102,702,770)	(99,318,667)
Aktivet financiare të matura me VDATGj		(12,154,551)	-
Të pagueshme drejt Shoqërisë së Administrimit		147,429	118,399
Detyrime të tjera		415,898	(42,040)
		<b>(122,747,612)</b>	<b>(98,502,834)</b>
Interes i arkëtuar		36,547,291	31,572,285
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti operacional</b>		<b>(86,200,321)</b>	<b>(66,930,549)</b>
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet financuese</b>			
Kontributet marrë nga kontribuesit		106,132,292	86,093,539
Kontributet të paguara kontribuesve		(20,092,132)	(19,343,949)
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>86,040,160</b>	<b>66,749,590</b>
<b>Zvogëlim neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to</b>			
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit		9,078,383	9,259,342
<b>Paraja dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit</b>	<b>14</b>	<b>8,918,222</b>	<b>9,078,383</b>

